



USHTRIA




Viti i 78-të i botimit Nr. 3 (827910)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 24 janar 2025

FARSH, vlerë e shtuar e Aleancës



» faqe 4

Gjenerallejtënant Kingji priti përfaqësues të Operacionit “Interflex”

Shefi i SHPPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji priti ekipin e koalicionit ndërkombëtar të kryesuar nga Mbretëria e Bashkuar, të titulluar “Operacioni Interflex”. Ky takim u realizua në vijim të angazhimit të vendit tonë për të kontribuar me personel trajnues në Operacionin “Interflex”, i cili zhvillohet në Mbretërinë e Bashkuar, dhe kishte fokus koordinimin e masave administrative në interes të materializimit të këtij angazhimi.

Gjatë këtij takimi, gjenerallejtënant Kingji vlerësoi punën e bërë nga personeli i Operacionit “Interflex” për trajnimin e personelit ukrainas, ofroi një panoramë të mbështetjes dhe kontributit të dhënë nga vendi ynë për Ukrainën, që nga fillimi i sulmit të paprovokuar në Ukrainë, si dhe theksoi vullnetin për të vijuar mbështetjen në të ardhmen, në interes të rivendosjes së integritetit territorial të Ukrainës. Në këtë drejtim, së shpejti FARSH do të dërgojë në qendrën trajnuese në Mbretërinë e Bashkuar instruktorë të fushave të ndryshme, ku përfshihet lidërsia, taktikat konvencionale dhe jo konvencionale, xhenio, EOD, shëndetësi, etj. Koalicioni i Operacionit “Interflex” është krijuar në vitin 2022 dhe ka për qëllim trajnimin e personelit të Forcave të Armatosura të Ukrainës. Ai përbëhet nga 15 vende aleate dhe partnere të NATO-s dhe përgjatë dy viteve të tij ka trajnuar mbi 50,000 pjesëtarë të FA-ve të Ukrainës. Angazhimi i FARSH-së në këtë operacion vjen në vijim të kontributit domethënës të dhënë nga vendi ynë, që përfshin trajnimin e një kompanie të



Forcave të Armatosura të Ukrainës në vendin tonë, dhurim armatimi, municioni, automjetesh dhe lënde eksplozive. Për më tepër, vendi ynë është pjesë e operacionit të drejtuar nga NATO për koordinimin e ndihmës dhe trajnimit për Ukrainën, (NATO Security Assistance and Training for Ukraine, NSATU), dhe së shpejti do t'i bashkohet dhe Qendrës së Përbashkët të Analizës, Trajnimit dhe Arsimimit për Ukrainën, (Joint Analysis, Training and Education Centre, JATEC) në Poloni.



Mesazh urimi i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për 104 - vjetorin e krijimit të Armës së Xhenios

Me rastin e 104 - vjetorit të krijimit të Armës së Xhenios, kam kënaqësinë të uroj të gjithë xhenierët që kanë shërbyer dhe shërbejnë me përkushtim dhe guxim në këtë armë të rëndësishme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Një urim të veçantë kam për efektivat e togës EOD që vijnë me sukses misionin “Forward Land Forces” të NATO-s, në Letoni.

Duke u përballur me misione, emergjenca dhe sfida të mëdha, xhenierët kanë treguar gjithmonë angazhimin dhe profesionalizmin e tyre për të siguruar kthimin në normalitet të zonave të prekura nga katastrofat natyrore, emergjencat civile, infrastrukturën në ndihmë të popullsisë dhe mbështetjen e aktiviteteve të Forcave të Armatosura. Gjithashtu, kjo ditë është një moment i veçantë për të kujtuar sakrificat e gjithë xhenierëve në shërbim të Forcave të Armatosura, por edhe për të nderuar me krenari xhenierët që ranë në krye të detyrës, nga dëshmorët e fundit, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj, të cilët bënë sakrificën sublime për sigurinë e zonave të rrezikshme në kufijtë lindorë të Aleancës së NATO-s. Gjithashtu, dëshiroj të vlerësoj arritjet dhe përpjekjet e vazhdueshme për modernizimin e mëtejshëm të sistemeve dhe pajisjeve të Armës së Xhenios, e cila si një kapacitet kombëtar ka rolin e saj të pazëvendësueshëm për mbështetjen e trupave, përmirësimin e infrastrukturës ushtarake dhe civile, duke kontribuar në forcimin e sigurisë dhe zhvillimin e vendit. Në këtë ditë, ju uroj suksese të mëtejshme në misionet brenda dhe jashtë vendit, si dhe vazhdimësi në traditat e nderuara që kanë karakterizuar gjithë xhenierët, që nga data 20 janar 1921, dita e krijimit të kësaj arme, deri në ditët e sotme. Nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ju siguroj mbështetje të plotë në çdo hap të zhvillimit të modernizimit të mëtejshëm të Armës së Xhenios!



Arma e Xhenios, 104 vjet histori suksesi

U zhvillua në ambientet e Batalionit të Xhenios ceremonia e 104-vjetorit të Krijimit të Armës së Xhenios, e cila daton më 20 janar të vitit 1921.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, zëvendëskomandanti, kolonel Shkëlqim Çela, shefi i Shtabit, kolonel Idriz Kuca, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mëhillaj, si dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e mirëseardhjes, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mëhillaj, bëri një përshkrim të shkurtër historik të xhenios ndër vite, që nga momenti i krijimit dhe deri në ditët e sotme, si dhe falënderoi efektivët xhenierë për përkushtimin e treguar në punën e tyre.

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, në fjalën e tij përshëndetëse, përgëzoi të gjithë specialistët xhenierë dhe personelin civil, të cilët kanë shërbyer ndër vite me përkushtim të lartë, si dhe për kontributin e jashtëzakonshëm në: eliminimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, ndihmën për përmirësimin e infrastrukturës civile të vendit tonë dhe operacionet EOD për asgjësimin e municioneve të gjetura, që vinin në rrezik sigurinë e komunitetit. Gjithashtu, gjeneral Pando theksoi kontributin e çmuar në misionin e NATO-s të Prezencës së Përpunuar eFP në Letoni, duke kujtuar me respekt dhe mirënjohje dëshmorët xhenierë që dhanë jetën në krye të detyrës.

FARSH, vlerë e shtuar e Aleancës

Në kuadër të angazhimeve politike të Republikës së Shqipërisë, në luftë kundër terrorizmit, Forcat e Armatosura janë angazhuar dhe marrin pjesë aktive në operacione ndërkombëtare, në misione të ndryshme jashtë vendit, si pjesë e pandarë e operacioneve të drejtuara nga NATO, BE, OKB dhe koalicionet e përbashkëta të partnerëve tanë strategjike. Më 9 shtator 1996, FARSH-të kanë filluar misionin e parë në Bosnje-Hercegovinë. Numri i trupave pjesëmarrëse në Operacionet e Mbështetjes së Paqes (OMP) është rritur, ashtu siç është rritur edhe gjeografikisht numri i vendeve apo rajoneve ku ato kanë kryer operacione.

Pjesëmarrja e FARSH-ve në misione paqeruajtëse dhe luftarake buron nga misioni kushtetues i FARSH-së dhe baza ligjore e përcaktuar për secilin kontribut në misione paqeruajtëse apo luftarake. Kontribute të FARSH, në operacione ushtarake të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB, nga muaji shtator i vitit 1996 dhe deri në muajin dhjetor 2023 (grafiku), janë gjithsej 8622 ushtarakë.

Me rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe atyre logjistike brenda vendit, Forcat e Armatosura nga viti në vit po rrisin edhe kontributin në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, jo vetëm sa i përket numrave, por edhe hartës së angazhimeve ushtarake në mbështetje të paqes anembanë globit.

Në vitin 2025, FA do të ketë prani të shtuar me 50 trupa në misionet e KFOR-it në Kosovë, ALTHEA në Bosnje-Hercegovinë, NSATU dhe Operacionin "Interflex", dy të fundit në mbështetje të Ukrainës, duke konfirmuar dinamizmin e angazhimeve të Shqipërisë në mbështetje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në botë.

Forcat e Armatosura kanë qenë pjesë e operacioneve dhe misioneve paqeruajtëse përkrah aleatit tonë strategjik NATO.

Për vitin 2015, niveli i angazhimit të FARSH-së në operacione dhe misione ndërkombëtare, NRF, në kuadër të 'Masave të Sigurisë' dhe të 'Planit të Veprimit të Gatishmërisë' së Aleancës, parashikon një shifër totale prej 286 ushtarakësh (pa llogaritur rotacionet e misioneve).

Për vitin 2016 niveli i angazhimit të FARSH-së në operacione dhe misione ndërkombëtare, NRF, në kuadër të 'Masave të Sigurisë' dhe të 'Planit të Veprimit të Gatishmërisë' së Aleancës ka qenë 413 ushtarakë (pa llogaritur rotacionet e misioneve çdo 6 muaj).

Për vitin 2017 niveli i angazhimit të FARSH-së në operacione dhe misione ndërkombëtare, NRF, në kuadër të 'Masave të Sigurisë' dhe të 'Planit të Veprimit të Gatishmërisë' së Aleancës parashikohet të jetë 619 ushtarakë.

Për vitin 2018, përveç kontributeve aktuale, ministri i Mbrojtjes ka miratuar shtimin e



kontributit të FARSH me 52 ushtarakë në operacionin "RSM", në Afganistan dhe 3 ushtarakë në Prezencën e Përparuar të Përfuruar të NATO-s (eFP) në Letoni.

Nëntor 2019 niveli i angazhimit në operacione dhe misione ndërkombëtare është si vijon: në "RSM", Afganistan vijon kontributi i FARSH me 132 ushtarakë; në KFOR, Kosovë, vijon kontributi i FARSH me 29 ushtarakë; "ALTHEA", vijon kontributi i FARSH me 1 ushtarak; "EUTM Mali", vijon kontributi i FARSH me 4 ushtarakë; "Aegean Sea" në detin Egje vijon kontributi me 22 ushtarakë; në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përfuruar (eFP), Riga, Letoni vijon kontributi i FARSH me 21 ushtarakë; në operacionin ushtarak UNMISS në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë (kontribut i shtuar gjatë vitit 2019).

Në dhjetor 2021 në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përfuruar (eFP), Riga, Letoni vijon kontributi i FARSH me 21 ushtarakë; në KFOR, Kosovë, vijon kontributi i FARSH me 27 ushtarakë; "ALTHEA", vijon kontributi i FARSH me 1 ushtarak, në operacionin ushtarak UNMISS në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë.

Në dhjetor 2022 në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përfuruar (eFP), Riga, Letoni vijon kontributi i FARSH me 82 ushtarakë; në KFOR, Kosovë, vijon kontributi i FARSH me 170 ushtarakë; "ALTHEA", vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë, në operacionin ushtarak UNMISS në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 2 ushtarakë; në Novo

Selo, Bullgari vijon Aktiviteti i Vigjilencës së Përfuruar (enhanced Vigilance Activity - eVA) me 60 ushtarakë; në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit në Misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhgimit (Multinational Force and Observations MFO) me 3 ushtarakë; në operacionin ushtarak UNMISS në Sudanin e Jugut, në kuadër të OKB vijon kontributi i FARSH me 4 ushtarakë.

Më 25 qershor 2023 ka filluar kontributi i Forcave të Armatosura në Misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhgimit (Multinational Force and Observations - MFO) në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit, me rotacion 1 - vjeçar me 3 ushtarakë nga Policia Ushtarake.

Duke filluar nga 29 nëntor 2022, FARSH është angazhuar në Aktivitetin e Vigjilencës së Përfuruar (eVA) në Novo Selo, Bullgari.

Kontingjenti i FARSH-së, i përbërë nga 30 ushtarakë, dislokohet në përbërje të Grup-batalionit të NATO- në kufijtë lindorë të Aleancës. Vend drejtues i këtij misioni është Italia.

Rotacioni i kontingjenteve është çdo 6 muaj. Vijon kontributi i FARSH-së në operacionin ushtarak United Nations Mission In South Sudan - UNMISS në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara - OKB me 2 ushtarakë, kontribut i shtuar gjatë vitit 2019.

Në total 10 ushtarakë.

Shtohet në gusht 2023 kontributi i FARSH-së, me 1 efektiv të FARSH-së, rotacion 1- vjeçar në UNISFA, zona Abeyi.

Duke filluar nga qershori i viti 2017, FARSH është angazhuar me një togë EOD si

pjesë e grup - batalionit kanadez të Prezencës së Përparuar të Përfuruar të NATO (eFP) në Letoni të përbërë nga 18 ushtarakë.

Ministri i Mbrojtjes ka miratuar shtimin e kontributit të FARSH me 3 ushtarakë në eFP në Letoni.

Vijon kontributi i FARSH gjatë vitit 2022 në operacionin e NATO-s në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përfuruar (eFP), Riga, Letoni me 41 ushtarakë.

Vijon kontributi i FARSH-së gjatë 6-mujorit të parë 2023 në operacionin e NATO-s në kuadër të Prezencës së Përparuar të Përfuruar (eFP), Riga, Letoni me 44 ushtarakë dhe konkretisht: 1 togë EOD në BG kanadez, me 20 ushtarakë, 1 pozicion në HQBG kanadez, 1 pozicion në Rajonin e 3 të ACCI, në Letoni.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë u angazhuan në operacionin ushtarak të NATO-s "Aegean Sea", në nëntor 2016, në detin Egje me 1 (një) anije e klasit "Iliria" dhe një ekuipazh prej 21 ushtarakësh.

Misioni, është kryerja e patrullimit detar në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, Standing NATO Maritime Group 2 (SNMG2), në detin Egje, në kuadër të operacionit të NATO "Aegean Sea".

Kontributi i i FARSH-së, duke filluar nga 21 nëntori 2016 dhe deri më nëntor 2019 është 302 ushtarakë.

Gjatë 2023 rifillon kontributi i FARSH rotacion me periudhë 3 - mujore në "Aegean Sea" me 1 (një) anije e klasit "Iliria" dhe një ekuipazh prej 21 ushtarakësh.

Përfundon stërvitja "Feniks 2025"

Kursi i 60-të Bazë i Nënoficerit e mbylli me sukses stërvitjen komplekse 24-orëshe, të titulluar "Feniks 2025".

Pas një trajnimi intensiv dymujor në lëndët e përgatitjes fizike, zjarrit, taktikës dhe lidershipit, kursantët kanë demonstruar aftësitë e tyre si komandantë skuadrash.

Stërvitja, e cila kishte për qëllim të vlerësonte përgatitjen dhe kapacitetet e pjesëmarrësve u ndoq nga komandanti i Qendrës së Arsimitit Profesional të Nënoficerëve, kolonel Besim Bala, së bashku me stafin e instruktorëve. Ata theksuan profesionalizmin dhe përkushtimin e kursantëve, të cilët kanë dhënë një shembull të shkëlqyer të angazhimit në zhvillimin e aftësive dhe dënimet të nevojshme për rolin e nënoficerit.

Kursi i 60-të është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të karrierës ushtarake të efektivëve të rinj, të cilët janë tashmë të gatshëm të përballen me sfidat e ardhshme.





Forca Detare/Roja Bregdetare përcjell Kontingjentin VII me mision në detin Egje

Në Distriktin e Jugut, Pashaliman, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së Kontingjentit VII të anijes “Butrinti” të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, i cili do të marrë pjesë në operacionin e NATO-s në detin Egje.

Në ceremoni mori pjesë zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Altin Kurti, i cili gjatë fjalës së tij përshëndetëse falënderoi dhe vlerësoi kontributin e deritanishëm të efektivëve të Forcës Detare. Ai theksoi se: “Pjesëmarrja e Forcës Detare në këtë lloj misioni të rëndësishëm të NATO-s është histori suksesi, duke filluar nga kontingjenti i parë në korrik të vitit 2023 e deri te Kontingjenti i 7-të që po nis sot.

Histori suksesi është edhe pjesëmarrja e anijes ‘Butrinti’ dhe ekuipazhit të saj për herë të dytë, krahas dy anijeve të tjera të mëparshme ‘Lissus’ dhe ‘Oriku’ e porsa kthyer nga misioni, ku Forca Detare shqiptare në të gjitha këto misione ka dhënë një kontribut të çmuar në shpëtimin e jetëve njerëzore, mes të cilëve gra e fëmijë në kushte tejet të vështira. Çdo kontingjent ka ngritur më lart imazhin e Shqipërisë dhe Forcave të saj të Armatosura, duke shkruar faqe të reja nderi dhe përkushtimi në operacionet e NATO-s”.

Komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, kundëradmiral Adnand Agastra, u shpreh se: “Angazhimet tona, si në detin Egje ashtu edhe në operacione të tjera, janë një kontribut i prekshëm dhe i rëndësishëm për Aleancën. Jam i bindur se ky përkushtim do të vazhdojë me sukses edhe në të ardhmen, duke rritur peshën e kontributit që Shqipëria jep për NATO-n.”

Misioni ka për qëllim parandalimin e flukseve të emigrantëve të paligjshëm dhe më e rëndësishmja, shpëtimin e jetëve të personave në rrezik në ujërat e detit Egje.

Ceremonia u përmbyll me dorëzimin e Flamurit Kombëtar nga komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, kundëradmiral Adnand Agastra, te komandanti i kontingjentit, kapiten i rangut të tretë Mario Myftari.



“

KOMANDANTI I
FORCËS DETARE/
ROJËS BREGDETARE,
KUNDËRADMIRAL
ADNAND AGASTRA,
U SHPREH SE:

“ANGAZHIMET TONA, SI
NË DETIN EGJE ASHTU
EDHE NË OPERACIONE
TË TJERA, JANË NJË
KONTRIBUT I PREKSHËM
DHE I RËNDËSISHËM
PËR ALEANCËN.

JAM I BINDUR SE KY
PËRKUSHTIM DO TË
VAZHDOJË ME SUKSES
EDHE NË TË ARDHMEN,
DUKE RRRITUR PESHËN
E KONTRIBUTIT QË
SHQIPËRIA JEP PËR
NATO-N.”

Përrallë në ditë dimri...!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një ngjarje nga e përditshmja

Kur isha e vogël mendoja që shtëpia e babait ishte edhe shtëpia ime, për më tepër, kur më pyeste dikush se ku e kam shtëpinë, ia bëja me gisht nga shtëpia e babait.

Por, kur u rrita më treguan se kjo nuk është shtëpia ime. Shtëpia jote është te burri yt. “Bijë, vajza është e derë e botës”, më ngushëllonte nëna ime!

Por unë nuk e besoja, thosha se e ka vetëm për të më qetësuar, se shtëpia e babit do të jetë gjithmonë edhe e imja dhe ia plasja vajit!

Kur shkova te burri, jetonim të gjithë bashkë dhe për disa vite ende zemra më qëndronte te shtëpia e babait, por kur u “ndamë” dhe secili kunat shkoi në shtëpinë e tij, burri më puthi në ballë dhe më tha: “Grua e dashur, kjo është shtëpia jonë dhe e bijve tanë, e gëzofshim!”.

I besova buzëve të tij dhe sinqeritetit të tij, sepse asnjëherë nuk më kishte gënjyer, për këtë e shkruva tërë trupin tim, duke e mirëmbajtur shtëpinë time.

Kaloi një kohë dhe ‘gjysma ime më e mirë’ u largua nga kjo jetë.

Fëmijët u rritën e u bën për martesë. “Shtëpinë time” të vogël, por që e ngroha me shpirtin tim gjithë këto vite, nuk e donte më askush dhe një ditë bijtë e mi vendosën ta prishin “shtëpinë time” dhe më premtuan se do të ma ndërtojnë një shtëpi më të re, më të bukur dhe më të madhe! Më rrodhën lotët nga zemra ashtu si dikur, kur u ndava nga shtëpia e babait!

U ndërtua “shtëpia ime” e re, ma caktuan dhomën më të vogël, aty ku më shumë loznin nipërit e mbesat se sa që rrija unë!

Por në shtëpinë time të re, tani më, nuk guxoja të flisja, nuk kisha të drejtë të këshilloja e as të propozoja! Më dukej vetja si një “cung i vjetër” në shtëpi të re, dhe ashtu isha. Çdo gjë në këtë shtëpi ishte e re, edhe gozhdët ishin më të reja se unë!

Derisa një ditë djali më tha: “Nënë, do të dërgoj sot në një shtëpi të re!”

Sapo e dëgjova këtë fjali, e kuptova se as kjo shtëpi nuk genka e imja!

Dhe më solli këtu në “shtëpi të pleqve”, në shtëpi të atyre që kurrë në jetën e tyre s’kanë pasur shtëpi!

Por nipi kur më vizitoi për herë të fundit më bëri me lot kur më tha në vesh:

“Gjyshe, kur të rritem unë, do ta ndërtoj një shtëpi, ajo do të jetë shtëpia ime dhe shtëpia jote”.

E përqafova fort atë dhe i thashë: “Biri im, të pastë gjyshja ty, se gjyshja në këtë dynja kurrë s’ka pas shtëpi, por do Zoti më jep një shtëpi në botën tjetër, e do ta lus Zotin që të na bashkojë aty, aty ku asnjëherë nuk do të ketë ndarje e lot”.

Nga jeta e një nëne, ku dallgët e jetës e hodhën nga një vuajtje në tjetrën! Kjo është një sagë e familjeve shqiptare dhe jo vetëm për hir së të vërtetës. Shoqërisë shqiptare po i prishet një ekuacion tradicional shumë i mirë i saj, ekuacioni e kërkon që në fund të jetës së tyre, ky kujdes t’iu kthehet nga pinjollët. Edhe ata që janë në emigracion të mendojnë se këtu kanë lënë prindërit, për të cilët duhet të tregojnë pikësëpari kujdes shpirtëror dhe më pas financiar, për t’i ndihmuar ata që të zbusin plagën e pleqërisë së vetmuar, të braktisur nga fëmijët e tyre, për shkak të emigracionit apo se fëmija i tyre nuk mund të jetojë bashkë me prindërit.

Kjo krizë e dukshme në jetën e të moshuarve, vihet re për herë të parë në vendin tonë, pasi në vitet e shkuara ka dominuar familja patriarkale, ku prindi kishte autoritet të padiskutueshëm ndaj fëmijës. Tani po ndodh e kundërta.



Nuk është fjala për t’u kthyer sërish te familja patriarkale, por për një sensibilizim të mundshëm të shoqërisë shqiptare dhe shtetit, me qëllim që të parandalohet një fenomen i tillë, por edhe që të merren masa organizative, me qëllim që jeta e këtyre të moshuarve, të cilët kanë kontribuar për këtë shoqëri, një jetë të tërë, të mos nëpërkëmbet.

Kuptohet që marrëdhëniet midis brezave janë produkt historik, ato jo gjithmonë ndjekin në të njëjtën kurbë dhe asnjëherë nuk janë të ngjashme dhe të pandryshueshme. Kur shoqëria ndryshon, kur kalon nga një sistem në një tjetër, nga një formë organizimi në një tjetër të re, ndryshon familja, organizmi i saj, mënyra e jetesës dhe marrëdhëniet midis brezave. Këtu nuk është fjala thjesht në papajtueshmërinë e të rinjve me të vjetrit në mendime, pasi lufta psikologjike midis brezave nuk është e sotme. Në çdo kohë, brezi i ri është në konflikt me brezin e vjetër, por çështja është që të shmangim përjashtimin e njëri-tjetrit.

Familja e re, e quajtur moderne, duhet pranuar se po lëviz në drejtim të kundërt me familjen tradicionale, me normat dhe

që kanë sjellë në jetë 3,4, 5 apo dhe më shumë fëmijë dhe prej vitesh nuk dinë për fatin e njëri – tjetrit. Kjo është pa diskutim maskaradë njerëzore.

Të moshuar të vetmuar i kanë gjetur në shtëpi pa jetë ditë më vonë nga ndalimi i frymëmarrjes. Kur era e shkaktuar nga dekompozimi i trupit ka marrë shkallët e pallatit. Dhe kjo vjen si pasojë e mungesës së kujdesit për prindërit nga ana e fëmijëve. Ndihma ndaj tyre nuk konsiston vetëm në mbajtjen e tyre në një apartament, por dhe duke i telefonuar një herë në ditë, duke u çuar ndonjë ushqim në formë ndihme, duke i çuar për vizitë mjekësore dhe blerë ilaçet e nevojshme, duke i marrë një herë në javë për një kafe, jashtë në lokal, ose duke e pirë kafën bashkë me ta, në shtëpinë e tyre.

Pra, që fëmija ta dijë, se edhe sot prindi i tij është gjallë dhe të mos e marrë vesh vdekjen e tyre prej komshiut. Dhe të mos harrojmë se asnjë prej nesh nuk do të ishte i gjallë, nëse dikush do të kishte vendosur të na largonte me dhunë nga kjo botë. Jeta e të gjithë njerëzve, përfshirë këtu shkencëtarët, filozofët, artistët,



kriteret e ndërtimit të marrëdhënieve midis brezave.

E keqja më e dukshme është mungesa e respektit midis pjesëtarëve në familjen shqiptare, ku është venitur ndjenja e përcjelljes së respektit për të moshuarit, e cila besoj se është një nga normat më të vjetra dhe më të pëlqyeshme në historinë e njerëzimit.

Respekti njerëzor, detyrimi i fëmijës ndaj prindit, nuk mund të konsiderohet një normë e vjetruar, por një virtyt moral, i cili jo vetëm nuk duhet të shuhet, por do të ishte mirë të ngjitej në një shkallë më të lartë. Respekti i fëmijës ndaj prindit është një borxh moral e shpirtëror që u duhet kthyer atyre, pasi të njëjtën gjë ka bërë dhe prindi ndaj fëmijës së vet.

Histori të dhimbshme shohim dhe dëgjojmë çdo ditë, prindër

politikanët, mendjet gjeniale, shpikësit, shenjtërit, bamirësit, simbolet e bukuri fizike e shpirtërore, ka vijuar në saje të dashurisë njerëzore, të kujdesit dhe respektit për jetën. Dhe jeta nuk ka vlerë vetëm në fillesat e saj, vetëm në vitet e para, në rininë e saj, por ajo mbart në vetvete të njëjtën vlerë për gjithë vitet që zoti i ka caktuar secilit, nga lindja deri në momentin e largimit nga bota fizike për në botën shpirtërore.

Vajza, djem, bij nënash apo çfarëdo lloj statusi tjetër të keni, lëreni 5 minuta navigimin në internet apo lojërat “idiote” dhe përdorini telefonat për të folur me prindërit, ata gëzojnë veç t’ju dëgjojnë zërin. Mosha e pleqërisë apo, siç njihet ndryshe, “mosha e bardhë”, prej nga rrjedh dhe urimi “pleqëri të bardhë” kërkon më shumë nder dhe respekt nga familja, fëmijët, shteti dhe shoqëria.



Nënkolonel (R) Zabit Çuku

104 vite më parë do të formohej në Shqipëri për herë të parë Arma e Xhenios, një nga formacionet ushtarake kyçe në ushtrinë shqiptare të krijuar pas shpalljes së pavarësisë. Në këtë rrugëtim më shumë se njëshekullor, sfidat, transformimet, përballjet me situata të rrezikshme, por kurrë të papërballueshme i kanë bërë ushtarakë dhe civilë, pjesë e kësaj arme elitë, të kujtohen me mirënjohje, për përkushtimin dhe devotshmërinë e tyre në këto detyra të rëndësishme.

Një prej tyre është dhe nënkolonel (R) Zabit Çuku, i cili mes gazetës ‘Ushtria’ sjell përshëndetjen e tij për miqtë, kolegët, bashkëpunëtorët e tij në kremtimin e 104 – vjetorit të Armës së Xhenios.

LAVDI 104 VJETORIT TË ARMËS SË XHENIOS

(20 JANAR 1921-20 JANAR 2025)

LAVDI JETËS DHE VEPRËS NË PËRJETËSI ATYRE QË NUK JENTOJNË MË NGA ARMA E XHENIOS

Edhe unë, Zabit Çuku, kam qenë ushtar dhe oficer në Armën e Xhenios nga viti 1967 dhe tani me fillimin e vitit të 75 që kam ditëlindjen, një karrierë 45 vjeçare në Armën Xhenios dhe në FASH.

Uroj gëzuar 104-vjetorin e Armës së dashur të Xhenios Shqiptare. Lavdi 5 Heronjve, dhe 160 dëshmorët e Armës së Xhenios, respekt për qindra të plagosur, dëmtuar e gjymtuar nga aktiviteti me minat e municionet në Shqipëri.

Ishte 20 janari i vitit 1921, me vendim të qeverisë të dalë nga Kongresi i Lushnjës, krijohet Kompania e Parë Xheniere me 150 ushtarë dhe 5 oficerë në Divizionin e Ushtrisë Kombëtare. Me detyrë punime infrastrukture, kazerma, rrugë, ura e të tjera. Gjergj Kastrioti Skënderbeu një strateg ushtarak krijoi e përdori elementë të sigurimit xhenier të kohës si maskim, mashtrim, pritaj, hedhjen e gurëve, bllokim të rrugëve, grykave, hapjen e shkëmbinjve për mashtruar e kaluar trupat e veta, zjarret me prodhim tymi e barute djegëse, tymin në pika të dukshme, deri te Gurëdhësi shqiptar, i cili njihet edhe në ditët tona.

Në vitin 1928 u krijua komanda e parë e trupave xheniere, në vitin 1929 ishin 10 kompani xheniere, për nevojat e ushtrisë e komunitetit, pushtimi fashist, më 1939, e shkatërroi plotësisht ushtrinë dhe repartet xheniere.

Në vitet 1933-1935, shumë studentë Shqiptarë ishin në shkollën e Aplikacionit Artileri-Xhenio, në Torino me rezultate të larta, por ditën e betimit ata tradhtuan flamurin Italian e u kthyen në Shqipëri për çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Në LANÇ shumë partizanë luftëtarë përgatitën shumë elementë të veprimit e sigurimit xhenier, si lufta me mina, pengesa, shkatërtime e të tjera. Më 10 prill, 1944 urdhri Nr.116 i SHPUNAÇL që përgatiti dhe dolën skuadrat e para minatore-zapatore, në mbështetje të veprimeve luftarake në njësitë partizane deri në ngritjen e barrikadave për çlirimin e Tiranës dhe më pas atdheut, datë e cila mbetet historike pas 20 janarit të vitit 1921. Nga komanda e SHPU 26 maj 1945, krijohet reparti i parë xhenier, (batalioni Zapor-Minator) Laprakë, Drejtor i Komandës së Xhenios, majori Njazi Çepani, komandant batalioni majori Kadri Ibrahim me dy kompani, u vendos në plazhin e Durrësit për të kryer çminimin e bregdetit të minuar nga pushtuesit nazi-fashistë në ikje e sipër.

Ushtria gjermane 1943-1944 minoi rreth 400 kilometra gjatësi në bregdetin shqiptar: Saranda, Lumi i Matit e Shëngjini, me 100 mijë mina kundërtanke e 200 mijë mina kundër-këmbësorisë.

Trupat xheniere në zonën e Shkëmbit të Kavajës hoqën mbi 8 mijë mina kundërtanke e 2 mijë mina kundër-këmbësorie deri në shtator 1945.

Aty ranë heroikisht dëshmorët kapiten Panajot Haxhimihali, Zenel Skendo, Dilaver Hamzaji, Hazsi Tola, Arif Osmani, Din Shtëmbari, Luftar Cako, e Ytvi Velu dhe ushtarë gjermanë të kapur rob, të cilët kontribuan e dhanë jetën dhe për këta nuk ka sot një pllakë apo lapidar në këtë zonë, të cilën e vizitojnë mijëra turistë të huaj.

Viti 1949, në provokacionet greke trupat xheniere e të tjera hapën mbi 20 kilometra transhe dhe elementë të tjerë që penguan veprimet e ushtrisë Greke.

Për aktivitetet, veprimet e kryera nga trupa xheniere kanë shkruar e folur oficerë të nderuar xhenierë si: Veli Dedi, Mendu Baca, Alfred Moisiu, Nexhmi Menzelxhi, Abedin Galanxhi, Ramiz Fiçorri, Kosta Panajoti, Miti Gollosi, Thimi Lapi, Bujar Mancellari, Saba Bushi, Abil Zerhani, Besnik Alibali, Lulëzim Salillari, Thoma Vaso Dedë Prenga, Vasil Premçi e shumë të tjerë.

Trupat Xheniere Shqiptare kanë treguar veten si një domosdoshmëri e përfaqësuese e denjë e popullit e FASH në vepra praktike që janë sot histori e gjallë.

Nuk ka copë toke, rruge, mali, fushe, uji e kodra, ku nuk ka punuar dhe kontribuar Xhenio me oficerë civilë, ushtarë aktivë e rezervistë

NJË SHEKULL JETË, sfidë pa kompromise, ‘Arma e Xhenios’



të Shqipërisë në vite, pavarësisht kush ka qenë pushtet, detyrat tona kanë qenë dhe janë më se humane në interes së komunitetit.

Nuk ka zona nga Saranda, Përmeti, Himara, Puka, Vlora, Kukësi, Korça, Fieri, Vlora, Durrësi, Shkodra e Burreli, Progonati e Martaneshi, Librazhdi, e Sazani, që ishin detyrat dhe aktivitetet e përbashkëta të FASH me trupat xheniere dhe njësitë e tjera ushtarake. Tregues shumë real në komunitet për emergjencat civile si përmbytje hapje rrugësh e detyra shumë të rëndësishme drejtimi e zbatimi, ku ne jemi krenarë për arritjet dhe nivelin e këtyre kuadrove e trupave xheniere.

Rruga e gjatë e vështirë me sakrificë, me gjak dhe histori, ku ne kemi 5 Heronj të Popullit nga Xhemal Kada, Veli Dedi, e Shyqyri Alimerko, Heronj të Punës, Mendu Baca me disa Gjeneralë, shumë Kolonellë e shumë të tjerë me nivele dhe grada të larta, të cilët e kanë fituar me djersë dhe rezultat konkret. Kemi me qindra inxhinierë, të cilët sot po e tregojnë veten për nivelin e tyre drejtues në fushën e ndërtimit.

Kemi ish-xhenierin e nderuar 95-vjeçar dr. Alfred Moisiu deri në nivelin Kryetarit të Shtetit, President i Republikës Shqipërisë dhe ngelet më i nderuari dhe respektuari si drejtues shteti pas viteve 1990. Trupat xheniere nga vitet 1960-1985 kanë luajtur rolin kryesor në sigurinë e mbrojtjes, përgatitjen e veprimeve mbrojtëse, nga ndërtimi i objekteve fortifikuese si një domosdoshmëri e pajustificueshme në periudhën e Luftës së Ftohtë në ato vite.

Sot objektet fortifikuese të Shqipërisë janë vlerësuar në radhën e tretë nga studiues të huaj për cilësinë dhe sigurinë e tyre, si PZ, QZ, objekte si Gjadri, Porto-Palermo, Kuçova, Shëngjini, Uzinat Ushtarake, strehimet e popullatës, të drejtimit, komandimit, të cilat i kanë të gjithë vendet e zhvilluara në Perëndim e Lindje në ditë e sotme kanë shtuar masat buxhetore për ndërtimin dhe zgjerimin e prodhimit të armëve të reja më të sofistikuar.

Pas viteve 1990 trupat xheniere kryen me qindra misione për komunitetin nga ujësjellësi i Shupenzës në vitin 1994, rruga e Astirit, Fshati, Bathore ka riparuar dhe ndërtuar qindra ura e rrugë në gjithë territorin e Shqipërisë. Kjo është e do jetë Arma e Xhenios dhe duhet vlerësuar e respektuar nga secila qeveri ndër vite jashtë politikës.

Ne sot kujtojmë me respekt mbi 160 vetë dëshmorë dhe të rënë në krye detyrës dhe me qindra të plagosur e të gjymtuar nga puna, nga minat e municionet nga viti 1936 e deri te ngjarjet shkatërruese të vitit 1997, tragjedia Gërdecit 2008, marrja pjesë në pastrimin e 15 zonave, të cilat u infektuan nga shpërthimet e depove vitet 1997, në pastrimin e zonës kufitare Kukës e Tropojë nga minat bombletë, që hodhi ushtria serbe në vitin 1999, në luftën e Kosovës

Punën, veprën, aktivitetin e sakrificat, individuale dhe ato familjare e vlerëson populli e respektojnë edhe organizmat e huaja, pasi strukturat e shtetit, veçanërisht pas 1990, e kërkojnë xhenion kur ka përmbytje, emergjenca, zjarre, rrëzim urash apo tërmete.

Faleminderit oficerëve të repartit, civilëve, ushtarakëve, që sot është i vetmi repart xhenier në Shqipëri me kontribut shumë të madh nga viti 1990, ku sot jemi në operacione në ndihmë të komunitetit, janë me qindra ura, rrugë të riparuar, e ndërtuar nga këta xhenierë të nderuar.

Ministri i Mbrojtjes, SHPU më shumë vlerësim e mbështetje për Armën e Xhenios, e cila ka vlera të thella historike edhe për të ardhmen.

Si pasardhës veteran, ju përgëzoj, si dashamirës i xhenios e të

shumë qytetarëve të atdheut edhe për përfaqësimin tuaj në misione jashtë atdheut deri në fljimin e jetës me lavdinë e tyre të pavdekshme.

Lavdi Dëshmorëve të Armës Xhenios!

KONTRIBUTI I TRUPAVE XHENIERE NË KOMUNITET PAS VITIT 1990

Pas suprimimit të divizionit të xhenios në vitin 1991, Nr. 6188, kaloi Br.XH NR. 1020, e më pas në 2010 në Batalion Xhenier Nr. 1040 dhe ka kryer shumë detyra shumë të rëndësishme kryesisht për komunitetin dhe ndër vite.

Vitet 1991-1995

Ndërtimi i shesheve dhe infrastrukturës për fshatin e ri në Zallher; Hapja e trasës për rrugën e unazës; Ujësjellësi i fshatit Shupenzë; Ndërtime të urave “Bailey” të apareleve të hyrje-daljeve, sipas rasteve emergjente në disa zona të vendit.

Viti 1995

Hapja e 2 puseve të ujit të pijshëm, Spitali Ushtarak-Stërvitje “Uji Kristal” trupa SHBA; Punime te rruga Unaza e Re Astiri-Dogana; Rikonstruksion i rrugës Ura e Tomorricës-Krushovë, Gramsh; Rikonstruksion i rrugës Sauk-Farkë e Vogël.

Viti 1996

Rikonstruksioni i ujësjellësit Komuna Shupenzë, Bulqizë; Fillimi punës për ndërtimin e fshatit Bulqesh, pas përmbytjes së liqenit të Bovillës.

Viti 1997

Përfundimi i ndërtimit të fshatit Bulqesh, Tiranë; Kontribut në ndërtimin e Unazës së “Qytetit Studenti”.

Viti 1998

Pastrimi i ambienteve publike Tiranë; Riparim infrastrukture publike dhe reparte në Tiranë

Viti 1999

Rikonstruksion i shkollës 8-vjeçare Krujë, “Cooperative-Assamby”, ushtria franceze; Rikonstruksion i segmenti rrugor në Ishullin e Sazanit; Përfundimi i punimeve për projektin “ALBATROSS”, Durrës; Eliminimi i pasojave të përmbytjeve në Shëngjin, Lezhë; Rrethimi i portit të Durrësit; Kontribut në evakuimin e refugjatëve nga Kosova, ngritja e kampingjeve Tiranë, Berat, Laç.

Viti 2000

Rikonstruksion i fushës së aviacionit në Vlorë; Prishja e ndërtimeve pa leje pastrim mbetjeve urbane në Parkun “Rinia”; Fillimi i punës në zgjerimin e rrugës Llogara-Palasë.

Viti 2001

Punime në zgjerimin e rrugës Llogara – Palasë, 11 km e gjatë; Pastrimi i mbetjeve urbane në qendrën e Tiranës; Rikonstruksioni i rrugës Bogovë-Çorovodë; Ndërtim, asfaltim i rrugës krah lumit Mat, Pllanë, stërvitjes “Cornerstone 01”.

Viti 2002

Ndërtimi i rrugës Tropojë- Qafë Morinë me gjatësi 7,64 km; Ndërtimi i rrugës Qafë Mejdani – Qafë Morinë, Kukës; Riparimi i rrugëve rurale në rrethin e Mirditës, Lezhë; Riparimi i rrugëve rurale në rrethin Bulqizë, Dibër; Riparimi i rrugëve rurale në segmentin Zogaj – Gjuras, Komuna Shupenzë, Dibër; Shembja e urës së dëmtuar në Mullet, Tiranë; Operacione përballimi emergjencash natyrore, zhblllokim rruge nga dëbora veri; Pjesëmarrje në stërvitjen shumëkombëshe “Cornerstone 02” Plovdiv, Bullgari.

Viti 2003

Fillon punë segmenti rrugor Milot-Grëshen, Aksi Durrës-Kukës-Morinë; Përmirësimi i rrugës në Çorovodë, Skrapar; Përmirësimi i rrugës rurale në Moglicë, Korçë; Zhblllokimi i rrugës nga shembjet e dheut në rrugën Kukës-Shishtavec.

Viti 2004

Vazhdon ndërtimi segmentit rrugës Rubik-Kukës-Morinë; Përmirësimi i rrugëve Komuna Cakran, Fier, Komuna Lekbibaj, Tropojë; Përmirësimi i rrugës Kisha e Shën Ndout-Laç; Përmirësimi i segmentit rrugor Ura e Mesit-Bregu i Lumit, Shkodër; Riparim i rrugëve rurale Komuna Dajç-Shkodër; Përmirësimi i segmentit rrugor Biz-Martanesh, Tiranë; Përmirësimi i segmenteve rrugore Komunitat Vergo dhe Aliko, Sarandë; Përmirësimi i rrugës Kthesa Labova e



Kryqit, Komuna Libohovë, Gjirokaštër; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Komunën Kutalli, Berat; Pastrimi i qytetit të Shkodrës dhe i plazhit të Velipojës; Pastrimi inertesh, qyteti dhe plazhi Sarandë.

Viti 2005

Vazhdimi i punës segmenti i rrugës Rubik, segmenti Durrës-Kukës-Morinë; Zgjerim i segmentit rruga Dajt-Qafë-Mollë projekti i asgjësimit të lëndëve kimike; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Bashkinë e Shkodrës; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Komunën Iballë, Pukë; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në Komunën Vermosh; Riparimi i infrastrukturës rrugore në Bashkinë Maliq, Korçë; Riparim i infrastrukturës rrugore në Komunën Luftinjë, Tepelenë; Ndërtim dhe rikonstruksion rrugësh në Komunën Gjoricë, Bulqizë; Rikonstruksion i rrugëve rurale Komuna Macukull Derjan, Mat; Rikonstruksion i rrugëve rurale Komuna Gëzija, Lezhë; Ndërtimi i rrugës Komuna Saukut, Tiranë; Ndërtim trase rruge Komuna Baldushk, Tiranë; Përmirësimi i infrastrukturës rrugore Ndroq, Tiranë; Rikonstruksion i rrugës Dhivër, Sarandë; Përmirësimi i rrugës së Kalasë së Kaninës, Vlorë; Prishje e ndërtesës së Komitetit Ekzekutiv Sarandë, heqja materialeve inerte; Heqja e masivit shkëmbor në lagjen Mangalem, Bashkia Berat; Përballim emergjencash në Gjirokaštër, Vlorë, Berat, Përmet, Pukë, Tropojë, Kukës.

Viti 2006

Hapja e një rruge dhe ndërtim prite në lumin Fan, Bashkia Rubik; Rikonstruksion i rrugës Babrru-Paskuqan; Rikonstruksion shkolla Orizaj, rruga, Lapan-Çepan, stërvitja “Tomorri 2006”; Heqe e mbeturinave Fakulteti Ekonomik, Bashkia Tiranë; Rikonstruksion segmente rruge Dhëmblan, Lopëz, Tepelenë; Rikonstruksion rruge Poliçan-Sopik, Poliçan, Bashkia Gjirokaštër; Rikonstruksion i rrugës Topovë-Zhejë, Zagori, Bashkia Gjirokaštër; Rikonstruksion i rrugës Topovë-Ujarë, Bashkia Gjirokaštër; Ndërtim rruge, Ura e Dravovës-Konikol, Stërmbec, Dracovës-Zhepë, Përmet; Rikonstruksion i segmentit rrugor Ura e Këlcyrës-Malishovë; Punime me rrjetë teli masivi shkëmbor lagja Gorricë, Berat; Rikonstruksion rruge Shpal-Vau i Madh, Komuna Orosh, Mirditë; Rikonstruksion i segmentit rrugor Shkolla-Ura- Gurrë, Burrel; Përballimi i emergjencave nga bora në Qafë Mali, Kurbnesh dhe Lurë.

Viti 2007

Është punuar në dispozicion të 16 komunave e bashkive si: Në komunën Jalë, prishje dhe largim inertesh 2500 m³; Në autostradën e Tiranës, gërmim e transport mbeturinash; Në Piskovë Përmet, zgjerim i trupit të rrugës; Në Dardhë Pogradec, zgjerim i trupit të rrugës; Në Përrenjas Librazhd, hapje e trupit të rrugës; Në Velipojë Shkodër, ngarkim e transport materiali; Në Krastë Martanesh, zgjerim i trupit të rrugës; Në Baldushk Tiranë, zgjerim i trupit të rrugës; Në Melan Peshkopi, zgjerim i trupit të rrugës; Në Margegaj Tropojë, zgjerim i trupit të rrugës; Në Livadhja Sarandë, zgjerim i trupit të rrugës; Në Lukovë Sarandë, zgjerim i trupit të rrugës; Në Germim shkëmbi në Teqenë e malit Tomor; Në Gur i Bardhë Mat, zgjerim rruge e transport materialesh.

Viti 2008

Është punuar në dispozicion të 13 Komunave e Bashkive si: Baldushk, Margegaj, Lukovë, Gur i Bardhë, Sinanaj, Tepelene, Fush-Arrëz, Gërdec, Vorë, Velipojë, Luzni, Shalë, Malësi e Madhe, Peqin e Xibër; Angazhim i 47 mjeteve, duke përmirësuar 60 km rruge kategoria IV, dhe rrugë e re.

Viti 2009

Është punuar në dispozicion të 7 Komunave e Bashkive si më poshtë: Margegaj Tropojë, hapje rruge të re në komunë; Komuna Peqin, përmirësim rruge komune; Komuna Zall-Bastar, përmirësimi i rrugëve në komunë; Komuna Xibër Burrel përmirësim rruge; Komuna Petrelë, përmirësim infrastrukture rrugore; Bashkia Berat, ulje e shtratit të lumit Osum dhe përmirësim rruge; Komuna Farkë përmirësim të 6 km rruge.

Viti 2010

Në Margegaj Tropojë, për hapjen e një rruge të re, rreth 2 km; Në Komunën Tropojë e Vjetër për hapjen e segmentit rrugor 4.8 km; Në Komunën Fierzë, Tropojë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore; Në Komunën Ksamil, Sarandë, pastrim dhe sistemim sheshi; Në komunën Velipojë, Shkodër për ndërtimin e urës së drurit në Vilun; Në Komunën Farkë, Tiranë, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore; Në Komunën Lazarat, Gjirokaštër, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore; Në Komunën Fshat Memaliaj, Tepelenë zgjerim rruge, gjatësia e rrugëve 7,5 km; Në Komunën Qendër, Tepelenë për përmirësimin e rrugëve janë realizuar: Në Komunën Topojan Fier, për heqjen e qendrave të zjarrit nga plazhi; Në Komunën Piskovë, Përmet, hapje rruge të re, lidhjen e saj me urën “Bailey”; Në Kodër Vilë, Durrës, punime për përmirësimin e infrastrukturës në këtë objekt.

NDËRTIM URA “BAILEY”

Në Muriqan, Komuna Ana e Malit Shkodër urë “Bailey” 9 ml me seksion 1/1; Në komunën Tropojë e Vjetër, urë “Bailey” 12 ml me seksion 1/1, peshëmbajtje 15 tonë; Urë në fshatin Kuçanë, 15 ml e gjatë 1/1 dhe peshmbajtje15 tonë; Në Bashkinë Fushë Arrëz urë “Bailey” 64 ml, seksion 1/1 peshëmbajtje 15 tonë; Në Skuraj, Komuna Milot, ndërtuar urë 39 ml me seksion 2/1; Në Kryezi, Pukë, 2 ura me gjatësi 64 ml, seksion 1/1 peshëmbajtje 15 tonë; Komuna Margegaj, urë “Bailey”, Koçanaj 21ml, Dragobi 30 m seksion 2/1, peshë 25 tonë; Durrës Jub-Sukth, urë “Bailey” 114 ml seksion 2/2, 2/1) peshëmbajtje 20 tonë; Komuna Gurrë, Mat, urë “Bailey” 45 ml seksion 2/2 peshëmbajtje 20 tonë; Komuna Piskovë, Përmet, urë “Bailey”, 51 ml seksion 2/2 peshëmbajtje 15 tonë; Komuna Komsi, Mat, urë “Bailey” 21 ml seksion 2/1 peshëmbajtje 30 tonë.

PËR EMERGJENCAT CIVILE

Përballimi i përmbytjeve nga reshjet e shiut janë vënë në dispozicion: Në Paskuqan 1 Fadromë TC-135 2 astra v/sh; Në Laç 1 Fadromë TC-135, 2 mjete v/sh dhe 1 rimorkiator; Në Bashkinë Fushë-Arrëz, Pukë, është riparuar urë gjatësi 33 ml; Vrakë, Shkodër urë metalike “Bailey” 33 ml seksion 2/2, peshëmbajtje 55 tonë; Në Shkodër, komuna Postribë, urë “Bailey” 21 ml me seksion 1/1; Në Kaniçë, Shkrel, Malësi e Madhe, në dispozicion mjetet 1 TC-135 2 transporti; Në Fierzë B. Curri, janë angazhuar një mjet TC-135 për pastrimin e rrugëve.

Viti 2011

Hapje rruge e re në Komunën Gurrë, Mat me gjatësi 2,6 km; Komuna Horë-Vranisht, Vlorë, përmirësim 8 km, u hap 2 km rrugë e re; Në komunën Farkë riparinimin rruge me gjatësi 3 km.

Komuna Lazarat, Gjirokaštër, hapje traseje me gjatësi 5.2 km e gjerësi 5 m; Në komunën Fierzë Tropojë gërmim për hapje rruge 1,4 km; Në komunën Piskovë, Përmet, gërmim hapje rruge 4 km; Në Bashkinë Shkodër, gërmim, dhe largim materiale inertesh; Komuna Margegaj Tropojë, fadromë për emergjencat Civile; Në komunën Derian, Burrel, përmirësimi i rrjetit rrugor; Në komunën Qendër Librazhd, hapje rruge e re 1,4 km; Në komunën Pogon, Gjirokaštër, hapje rruge e re 3,4 km; Në komunën Markat, Sarandë, gërmim e zgjerim rruge 10 km; Në komunën Memaliaj, Tepelenë, hapje rruge 1 km; Në komunën Luftinjë, Tepelenë, përmirësim rruge 5 km; Në komunën Zall-Bastar, gërmim për zgjerim rruge 2,6 km; Në komunën Pajovë, Elbasan, riparim rruge Paulesh-Cacabezë 12 km; Në komunën Ballenjë, Mat, riparim rruge 2 km; Në komunën Shëngjergj, Tiranë, për riparim rruge.

URA BAILEY

Në komunën Hotolisht, Librazhd ndërtimi i urës 42 ml, 2/1; Në komunën Vig-Mnel, Shkodër çmontim, montim ure “Bailey” 27 ml tipi 2/1; Në sheshin “Nënë Tereza”, urë “Bailey” për gara kompania “Rally Albania”.

EMERGJENCA CIVILE

Komuna Kelmend, Shkodër, 1 Fadromë 135 eTC-135 dispozicion Komune; Në bashkinë Burrel 4 mjete dispozicion Emergjencave Civile.

Viti 2012

Komuna Gracen, Elbasan, hapje e përmirësim rruge e përgjithshme 2,5 km; Në Volloder, Sarandë, pastrim rruge dhe evadim materialesh; Komuna Margegaj, Tropojë, përmirësim rruge, hapje rruge 18.2 km; Në Komunën Luzni, Dibër Riparim rrugësh me gjatësi të përgjithshme 17,5 km; Evadim mbeturinash në Land Field-in Sharrë, Tiranë; Transport mbeturinash në Bashkinë Kamëz; Transport mbeturinash në Prefekturën Durrës; Përmirësim infrastrukture Burrel, ndërtimi i një këndi sportiv; Evadim mbeturinash urbane Bashkia Shkodër; Teqenë e Bektashinjve, gërmim zgjerim rruge me gjatësi 500 ml; Pastrimi, sistemimi Objekti Vendvarrimi Nënë Mbretëreshë, Tiranë; Objekti Orenjë Librazhd, riparim rruge Funar-Neshtë 7,1 km; Objekti Shezë, Elbasan riparim rrugës 3,2 km; Objekti Xibër Mat, riparim rruge Vilëz-Ketëmjeti 2,4 km

Viti 2013

Është punuar në 19 komuna, bashki, janë angazhuar 102 mjete xhenerie dhe 162 forca; Hapje rruge të re 54.5 km dhe përmirësim rrugel38 km; Operacione montim, riparim e çmontimin e urave “Bailey”; Është punuar në 14 komuna e bashki me 62 mjete 140 forca pune; Janë çmontuar riparuar, ndërtuar, urë këmbësorë, 8 ura “Bailey” 207 m.

OPERACIONE PËR MBROJTJEN EKOLOGJIKE

Është punuar në 2 komuna e bashki, pastrim segmentit rrugor Krujë-Fushë Krujë–Rinas; Pastrim segmentit rrugor Shkodër-Hani i Hotit; Punime xheniere në zona të rrezikuara;

Komuna Paskuqan Spitali “Nënë Tereza”, largim mbetje nga ndërtme pa lejë. Viti 2014

PUNIME NË NDIHMË TË KOMUNITETIT (INUK)

Ngarkim e transport mbeturina inerte Skelë-Uji i Ftohtë; Prishje objekti, Rruga e Elbasanit, ndërtesë në Dhërmi, Vlorë; Heqje materiali inert Levan–Mallakastër; Prishje Objekti Shtëpia Pushimit Dhërmi, transport inertesh; Prishje ndërtese Objekti 9-katësh transport inertesh në Durrës; Pastrime inertesh Objekti Skelë, Vlorë; Sistemim, heqje materiali Objekti, Dhërmi, Qarku Vlorë; Pastrim inertesh, Objekti, INUK, “Nënë Tereza”, Tiranë; Heqje mbeturinash inerte Objekti Lin, Pogradec; Prishje ndërtese Objekti Vaqarr, Tiranë; Prishje ndërtese Unaza e Re; Transport inertesh në afërsi të Gardës, Tiranë; Angazhim kompania EOD në mbështetje Operacionale.

KOMUNA DAJT

Hapje rruge, Priska e Madhe-Selbë, me gjatësi 1 km; Është punuar në 15 bashki e komuna me 161 forca, 37 mjete e 8 agregat.

NDËRTIM URE BAILEY

Ndërtimi ure “Bailey” Lunik, Librazhd, me gjatësi 21 metra të gjatë me seksion 2/1; Ndërtim ure “Bailey” Tërpan, Berat; Riparimi i urës “Bailey”, Katundi i Vjetër, Rubik, me gjatësi 15 m e tipit ½; Ndërtim Urë “Bailey” Kushovë, Gramsh gjatësi 21 m. seksion 1/1, 68, riparimi 15 m; Është punuar në 4 bashki, komuna, me 43 forca, 19 mjete dhe 3 agregate.

NË OPERACIONE MJEDISORE

Pastrim rruge Milot-Ishull Lezhë, Bashkia qytet, Omaraj-Koplik, Hani Hotit; Pastrim i segmentit rrugor Ura e Milotit-Burrel; Pastrimi i rrugës Gjirokaštër-Tepelenë; Pastrim rruge Elbasan-Rajcë-Qafë-Thanë-Korçë-Qafë-Cangoi- Bilisht; Pastrim plazhi i Currilave-Pista Iliria, Durrës, Borsh e Dhërmi; Është punuar me 6 drejtime, janë angazhuar 270 forca dhe 43 mjete.

NË EMERGJENCA CIVILE

Në dispozicion Komisariati Policisë Nr.4 Tiranë; Në dispozicion të Qarkut Lezhë, rreth-rrotullimin distancë 12 km, Shëngjin; Pastrim segmenti rreth-rrotullimi Lezhë-Milot 20 km 90 m³; Në Lundër, Arkivi Qendror i SSH, largim inertesh 289 m3; Në Lundër, për transportimin e materialeve të KQZ,142 m3.

Viti 2015

PUNIME NË NDIHMË TË KOMUNITETIT

Ndërtim ure “Bailey” Skënderbej, Gramsh 12 me seksion 1/1, peshëmbajtje 15 tonë; Ndërtim ure “Bailey” Orenjë, Librazhd 30 m. seksion 1/1, peshëmbajtje15 tonë; Riparim i urës “Bailey” Gurrë, Mat 42 m, seksion 2/2, Infrastruktura; Komunën Çepan përmirësimi rrjetit rrugor; Në Komunën Kushovë, hapje e rrugës Kushovë, Gramsh.

PASTRIM TË ZONAVE BREGDETARE

Zonat Divjakë, Qarku Fier pastrimin e bregdetit; Zonat Velipojë-Shëngjin, Shën Kollë-Gjiri i Lalzit; Zonat Rrushbull-Shkëmbi i Kavajës-Golem, Qerret, Kavajë.

2016

Ndërtim ure “Bailey”, Katundi i Vjetër, Mirditë 12 ml seksion 1/1 peshë 24 tonë; Ndërtim ure “Bailey”, Çermë, Divjakë 18 ml, seksion 1/1, peshëmbajtje 24 tonë; Ndërtim ure “Bailey” Xibër, Klos

42 ml, seksion 1/1 peshëmbajtje 15 tonë; Çmontim ure, Babrru 30 ml, seksion 2/1, pakompletuar; Ndërtim urë “Bailey” Kaftallë, Lezhë 27 ml seksion 1/1 peshëmbajtje 10 tonë; Në Tarazh, Malaj, Bashkia Mirditë riparim rruge 10 km; Me Stërvitjen “Mirdita 2016” segmenti i rrugës Sheshaj-Jezull.

PUNIME NË KOMUNITET

Hapje rrugë e re Tyrbe Shkëlzen, Tropojë, Gosturan-Shkalla e Zenelit 5 km; Riparimi i rrugës Krumë-Cahan e Golaj-Dobrunë, 7 km dhe 14,5 km; Riparimi i rrugës Shishtavec-Kroi i Bardhë, (AISM) Kukës; Ndërtimi i urës Viçidol, Tropojë, 9 m, seksion 1/1 peshëmbajtje 24 tonë; Ndërtimi i urës Mënik, Tiranë 60 ml, seksion 2/1 dhe peshëmbajtje 24 tonë; Ndërtimi i urës Zall-Bastar, Bashkia Tiranë; Ndërtimi i urës “Bailey” në Hllomo-Çatistë, Bashkia Dropull.

Viti 2018

Ndërtim rruge në komunën Gurrë, Mat me 2,6 km; Ndërtim rruge në komunën Horë-Vranisht, Vlorë 2,1 km; Hapje, përmirësim rruge Gracen, Elbasan, 2,7 km; Pastrim rruge nga mbetjet ndërtimore, Volloder Sarandë; Përmirësim rruge Margegaj, Tropojë, Markovce-Doberdol-Sulbicë 18.2 km; Riparim rrugësh Luzni, Dibër, Ura e Drinit - 3.5 km, Ura e Drinit, 5 km; Gjura e Lishanit – Hotesh, 6 km, Morlla Damzit – Lishan 3.5 km dhe 3 km; Evadim mbeturinash Land field-in Sharrë; Transport mbeturinash në prefekturën Durrës - përmirësim infrastrukture, riparim i rrugës, stadiumi Burrel; Evadim mbeturinash urbane Bashkia Shkodër; Teqeja e Bektashinjve, zgjerim rruge 600 ml; Vendvarrimi Nënë Mbretëreshë, Pallati Brigadave, Tiranë; Orenjë Librazhd, hapje rrugë e re 3 km; Në Shezë, Elbasan, hapje rrugë e re 3,2 km; Në Xibër Mat, hapje rrugë e re 2,5 km; Ndërtim arginature në lumin Vjosa, bashkia Fier.

“BAILEY”

Urë “Bailey” Voskopojë, Korçë 12m, seksion 1/1 peshëmbajtje 24 tonë; Urë “Bailey” fshati Mbrezhdan, Këlcyrë, 45 m, seksion 2/2 peshëmbajtje 24 tonë; Riparim urës tip “Bailey” në fshatin Darëzezë; Çmontimi urë “Bailey” 33 ml 2/1, fshati Hamull, Skrapar; Urë “Bailey” Jezull, Rrëshen, Bashkia Mirditë”; Çmontim, montimi ure “Bailey” Vanë, Delvinë 33m dhe seksion 1/1; Montim ure “Bailey” 33 ml, 2/1, peshëmbajtje 20 tonë, Dardhë, Librazhd; Janë angazhuar 94 forca, 51 mjete, në lumin Vjosa, 5 ura “Bailey” me 147 ml.

Viti 2019

Argjinaturë lumi Vjosa, Fier, 46.787 m3, materiale mbushëse; Urë “Bailey” Voskopojë, 12m, seksion 1/1 peshëmbajtje 24 tonë; Urë “Bailey” Mbrezhdan, Këlcyrë 45 m, seksion 2/2 peshëmbajtje 24 tonë; Riparim ure tip “Bailey” Darëzezë, dëmtuar nga reshjet e shiut; Çmontimi i urës “Bailey” 33 ml 2/1, në Hamull, Skrapar; Ndërtimi ure “Bailey” Jezull, Mirditë 24m, tipi 2/1 peshëmbajtje 40 tonë; Çmontim montim ure “Bailey”, fshati Vanë, Delvinë; Montim ure Dardhë, Librazhd, 33 ml, 2/1, peshëmbajtje 20 tonë.

Viti 2020

NË KOMUNITET

Evadim inertesh në Shijak, nga tërmeti i 26 nëntorit 2019; Ndërtim urë “Bailey”, Fan, Klos, Mirditë 24 m, seksion 2/1 peshëmbajtje 40 tonë; Ndërtim urë “Bailey” Mishter, Klos 12 m, seksion 1/1 peshëmbajtje 30 tonë; Ndërtim urë “Bailey” Pajun, Papër Elbasan, 42 m, seks. 2/1 peshëmbajtje 40 tonë; Ndërtim urë “Bailey” Arrëz, Elbasan, 42 m, seks 2/1 peshëmbajtje 40 tonë.

Këto punime për komunitetin janë një tregues konkret i ndihmës humane dhe direkte që kanë dhënë trupat xheniere, duke u lidhur ngushtë me komunitetin dhe për interesat e tij në raste emergjencash e fatkeqësish të ndodhur pranë në çdo rast.

Viti 2021

Në operacione EOD, sipas detyrave dhe situatave të krijuara, me dhjetëra raste emergjence për komunitetin në ndërtim urash “Bailey”, përmbytje, tërmeti, riparim rrugësh etj.

Urat “Bailey”, misioni vazhdon...

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu u shpreh se gjatë vitit 2025, planifikohet që të ndërtohen 12 ura të reja “Bailey” në disa nga zonat e vendit, ku ato janë më të nevojshme. Urat, si pjesë që lidhin komunitetet, ndihmojnë jo vetëm në çështjet e sigurisë, por edhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve në çdo cep të Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura do të vazhdojnë misionin për ndërtimin e tyre.

Gjatë vitit 2024 janë ndërtuar tetë ura “Bailey” me gjatësi totale prej 207 metrash, duke lidhur komunitete të izoluarra dhe lehtësuar jetën e banorëve.

“Plani për 2025 është edhe më ambicioz: 12 ura të reja do të ndërtohen në zonat më të nevojshme të vendit. Puna ka nisur me urën e re mbi lumin Lezedër, në fshatin Fshat të Bashkisë Klos”, - informoi ministri i Mbrojtjes.

Me ritme të larta dhe angazhim të përbashkët, do të vazhdojmë të afrojmë njerëzit dhe të ofrojmë zgjidhje konkrete për sfidat e përditshme të komuniteteve tona”, - përfundoi ministri Vengu.





21 JANAR 1925, SHQIPËRIA SHPALLET REPUBLIKË

Republika Shqiptare ishte emri zyrtar i Shqipërisë, i parashikuar në Kushtetutën e vitit 1925. Kuvendi Kushtetues, i dalë nga zgjedhjet e 27 dhjetorit 1923, duhej të vendoste dy çështje: formën e regjimit dhe kaktimin e kryeqytetit. Nga pikëpamja formale, Shqipëria ishte mbretëri, ndërsa Tirana po shërbente si kryeqytet i përkohshëm pa e pasur një status të tillë. Punimet e Kuvendit u hapën më 21 janar 1924, në përkujtim të 4-vjetorit të Kongresit të Lushnjës, me një mesazh të Këshillit të Naltë të lexuar nga Xhaferr Ypi. Për shkak të gjendjes së rëndë të krijuar në vitin 1924, Kuvendi Kushtetues nuk mundi të ushtrojë detyrën e tij dhe mbeti i shpërndarë gjatë gjysmës së dytë të vitit 1924, kohë kur qeverisi pakica parlamentare në sajë të kryengritjes së qershorit. Po në këtë kohë nisi edhe “gara” midis Tiranës, Elbasanit, Vlorës dhe Shkodrës në lidhje me kryeqytetin e ri të shtetit. Pas Triumfit të Legalitetit, Kuvendi Kushtetues i rifilloi punimet, më 17 janar 1925, me pjesëmarrjen e 61 deputetëve (nga 102 që ishin gjithsej). Këto punime i deklaroi të hapura deputeti Petro Poga. Më 19 janar 1925, u zhvillua debati në lidhje me ngjarjet e vitit të kaluar dhe dy ditë më vonë u zhvillua seanca që do të përfundonte me shpalljen e Republikës Shqiptare. Kryetari i Komisionit të Statutit, Petro Poga lexoi arsyet që kishte paraqitur ky komision në lidhje me shpalljen e republikës. Ky komision ishte ndarë në atë kohë në dy pjesë: në pro monarkistë dhe pro republikanë. Arsyet e paraqitura nga komisioni i posaçëm ishin hartuar qysh, më 3 prill 1924, dhe nuk kishin mundur për t’u propozuar për shkak të gjendjes së rëndë që ishte krijuar në Shqipëri në muajt prill – qershor 1924. Këto arsye ishin formuluar në 9 pika kryesore. Ato kishin të bënin me gjendjen historike, gjendjen shoqërore, gjendjen fetare, gjendjen politike, gjendjen financiare, çështjen e partizanisë, çështjen e aktualitetit dhe atë të vjeljes së mendimit të njerëzve të shquar. Në shpjegimin e arsyeve historike, komisioni arsyetonte se në Shqipëri nuk mund të zbatohesh parimi teokratik për shkak të mungesës së traditës së një familjeje mbretërore. Në lidhje me dinastinë e Wilhemit I, komisioni arsyetonte se “me largimin e tij nga Shqipëria dhe me marrjen pjesë në luftën e përgjithshme nën flamurin e një kombi të huaj, humbi të drejtën që i kishin dhanë mbi fronin e Shqipërisë”. Ndër “arsyet shoqërore”



PAS SHPALLJES SË REPUBLIKËS, MË 31 JANAR 1925, KUVENDI KUSHTETUES ZGJODHI AHMET ZOGUN TË PARIN PRESIDENT NË HISTORINË E SHQIPËRISË. PRESIDENTI ZGJIDHEJ NGA MBLEDHJA E PËRBASHKËT E DHOMËS SË DEPUTETËVE DHE SENATIT PËR NJË MANDAT 7-VJEÇAR. SHQIPËRIA U SHPALL MONARKI KUSHTETUESE NË VITIN 1928. ME FILLIMIN E SAJ, ITALIA KËRKOI TË ISHTE ALEATE ME REPUBLIKËN.

komisioni theksonte se “shqiptari në shpirt asht demokrat” dhe se “gjendja shoqërore e Shqipërisë tregon se e vetmja formë shtetërore që mund t’i përshtatet shqiptarit demokrat në shpirt, asht republika”. Interessant është shpjegimi në arsyet fetare. Komisionerët kanë përfshirë tërësisht identifikimin e kryetarit të shtetit me përkatësinë fetare. Në këtë pikë ata kanë kritikuar “kryengritjet e Zografosit, Haxhi Qamilit, ngatërrimet e Shkodrës më 1914” etj. Nga arsyet politike, komisionerët rendisnin se në procesin e përzgjedhjes së mbretit në vitet 1912 – 1913, ishin shfaqur një mori intrigash si brenda dhe jashtë vendit. Në lidhje me gjendjen financiare autorët pretendonin se forma e regjimit e propozuar prej tyre nuk kishte harxhime të tepërta në lidhje me kryetarin e shtetit. Ndërsa nga dijetarët, komisionerët kishin përzgjedhur Destunel de Costansi dhe Sami Frashërin. Pas paraqitjes së këtij raporti, deputetët filluan diskutimet. I pari e mori fjalën Vangjel Goxhomani. Në këtë fjalë ai tha se kishte qenë anëtar i pjesës monarkiste të komisionit të posaçëm për hartimin e statutit të shtetit. Më tej ai ka përmendur si shembull

kohën kur ka bërë studimet në Rumani pa harruar të shtojë se bindet të votojë pro republikës. Diskutimi i dytë ishte i Iljaz Vrionit, i cili qysh në fillim të tij theksoi se ishte me bindje monarkiste porse kishte ndërruar mendim dhe bindej se për momentin Shqipërisë i duhej një regjim republikan. Diskutuan edhe Mihal Kaso, Sulejman Starova dhe Ahmet Resuli. Në fund kryetari i Kuvendit Kushtetues, Eshref Frashëri shpalli votimin emër për emër. Të vetmit deputetë që nuk votuan pro formës së re të shtetit ishin deputetët Milto Tutulani dhe Niko Lezo (abstenuan). Të gjithë deputetët e tjerë të pranishëm në sallë votuan pro republikës. Pas shpalljes së republikës, më 31 janar 1925, Kuvendi Kushtetues zgjodhi Ahmet Zogun të parin president në historinë e Shqipërisë. Presidenti zgjidhej nga mbledhja e përbashkët e dhomës së Deputetëve dhe Senatit për një mandat 7-vjeçar.

Shqipëria u shpall monarki kushtetuese në vitin 1928. Me fillimin e saj, Italia kërkoi të ishte aleate me republikën.

Kjo u bë kryesisht për të rritur ndikimin e Italisë në Ballkan dhe për të ndihmuar sigurinë italiane dhe shqiptare



Z. KRYETARI.
Abduraman Dibra, po ; Ahmet Has-
stopalli, po ; Ahmet Resuli, po ;
Ahmet Zogu, po ; Ali Begeja, po ;
Anton Beça, po ; Rexhep Hyti, po ;
Bektash Corushi, po ; Dimosten Ha-
xholli, po, Eqerem Vlora, po ; Qani
Dishnica, po ; Ferid Vokopola, po ;
Fiqri Rusi, po ; Eshref Frasherri, po ;
Hafiz Xhemali, po ; Dr. Haki Mborja,
po ; Halit Roji, po ; Hamid Myftiu, po ;
Hasan Biçakciu, po ; Ibrahim Xhindi,
po ; Ilja Muzina, po ; Iljaz Virioni,
po ; Izet Dibra, po ; Jashar Erebara,
po ; Isuf Gijnali, po ; Kostaq Kotta,
po ; Kristaq Kosturi, po ; Lon Gjini,
po ; Mehmet Penjili, po ; Mihal Kaso,
po ; Milto Tutulani, (abstenon); Niko
Lezo, (abstënon) Petro Harito, po ; Pe-
tro Poga, po ; Pilo Papa, po, Qazim
Durmishi, po ; Qemal Karaosmani, po ;
Qemal Virioni, po ; Reuf Fico, po ;
Rexhep Jella, po ; Rexhep Matija, po ;
Salehydin Biloshmi, po ; Sali Babani,
po ; Salim Luniku, po ; Sali Vuçiterni,
po ; Sami Virioni, po ; Seid Toptani,
po ; Seid Virioni, po ; Sif Kedhi, po ;
Skender Pojasi, po, Sulejman Luzati,
po ; Sulejman Starova, po ; Dr. Syrja
Pojani, po ; Shas'var Alltuni, po ;
Shefqet Daji, po ; Shefqet Verlaci, po ;
Taqi Buda, po ; Telemak Labovitia-
dhi, po ; Terenc Toçi, po ; Vangjel
Goxhomani, po ; Xhelal Zogu, po ;
Zia Toptani, po ;
Duertrokritje të pa-premt e brohori
* Rroftë Republika Shqiptare *

në mosmarrëveshjet e tyre territoriale me Republikën e Dytë Helenike dhe Mbretërinë e Jugosllavisë. Pasi mposhti qeverinë e Fan Nolit, Ahmet Zogu mbloodhi parlamentin për të gjetur një zgjidhje për principatën e pakurorëzuar të Shqipërisë. Parlamenti miratoi shpejt një kushtetutë të re, e shpalli Shqipërinë republikë dhe i dha Zogut fuqi diktatoriale që e lejonin të emëronte dhe shkarkonte ministrat, të bënte veto ndaj legjislacionit, të emëronte të gjithë personelin kryesor administrativ dhe të zgjidhte një të tretën e anëtarëve të Senatit.

Kushtetuta e re parashikonte një republikë parlamentare, me një president të fuqishëm që shërbente si kreu i shtetit dhe i qeverisë.

Më 31 janar 1925, Zogu u zgjodh president për një mandat shtatëvjeçar nga Asambleja Kombëtare, përpara shpalljes së tij Mbret i Shqiptarëve. Ai e drejtoi Shqipërinë duke përdorur katër guvernatorë ushtarakë dhe emëroi krerët e fiseve si oficerë të ushtrisë rezervë, të cilët mbaheshin në gatishmëri për të mbrojtur regjimin kundër kërcënimeve të brendshme ose të jashtme. Ai gjithashtu mbajti marrëdhënie të mira me regjimin fashist të Benito Musolinit në Itali dhe mbështeti politikën e jashtme të Italisë.

Regjimi i Zogut thuhej se ishte përgjegjës për zhdukjen e partive opozitare dhe të lirive civile. Shtypi ishte gjithashtu i censuruar rreptësisht gjatë regjimit.

Në fillim të vitit 1925, filluan një sërë reformash të fokusuara në ekonomi, por rezultatet ishin të përziera. Disa nga reformat përfshinin organizimin e nismave private në industri, ndërtim dhe transport. Po atë vit u pre monedha e parë shqiptare, Franga e Artë Shqiptare. Kapitali i huaj u fut si pjesë e politikës zyrtare të qeverisë së Zogut I, por qëllimi i regjimit të tij ishte në fakt forcimi i pushtetit personal dhe pasurimi i mbështetësve të tij. Kapitali i huaj, huatë dhe forma të tjera, u përdor si mjet për të siguruar të ardhura për regjimin dhe më vonë u përdor për tejkalimin e krizave ekonomike.

Rreth kësaj kohe u krijuan katërmbëdhjetë shoqëri të reja, me një kapital fillestar prej 7,6 milionë franga ari, rreth 28% më shumë se kapitali i shoqërive në periudhën 1921-1924. Në vitin 1928, numri i ndërmarrjeve arriti në 127 dhe kapitali vendas ishte gjashtë herë më i madh se në vitin 1927, ndërkohë që ekonomia filloi të stabilizohej.

Në vitin 1925 u krijua Banka Kombëtare Shqiptare dhe iu dha koncesion investitorëve italianë. Shteti shqiptar kishte 49% të aksioneve të bankës, ndërsa Italia 51%. Në këto kushte, Italia fitoi një pozicion më të fortë në Shqipëri. Gjatë periudhës 1925-1928, qeveria shqiptare gjithashtu rriti

ndjeshëm kostot e saj.

Në vitin 1925 u krijua shoqëria SVEA (Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë), e cila ndihmoi në lehtësimin e marrjes së një kredie për Shqipërinë me vlerë 50 milionë franga ari. Në vitin 1927, kredia vlerësohej në 65 milionë franga ari. Interesi vjetor për këtë kredi 40-vjeçare ishte 7.5%. Shumat e shlyerjes përbënin 30%-40% të të ardhurave të të gjithë vendit.

Në vitin 1925, marrëveshjet ndërmjet agjencive financiare shqiptare (si SVEA) dhe grupeve financiare italiane, financuan 96,4% të projekteve të ndërtimit të rrugëve në Shqipëri. Këto kredi nuk ishin ekskluzivisht për nevojat urgjente ekonomike të vendit, por për të krijuar kushte për depërtimin e mëtejshëm të kapitalit të huaj në vend. Përgjegjësitë e departamenteve të qeverisë u shpërndanë për të rritur ndërtimin e rrugëve.

Në vitin 1928 çifligjet zinin një sipërfaqe prej 200.000 hektarësh (100.000 ishin çifligje private). Berati ishte qyteti me numrin më të madh të çifligjeve, me rreth 36.000.

Infrastruktura ishte mjaft problematike gjatë kësaj periudhe. Rrugët mund të transportonin vetëm automjete më të lehta, ndërsa urat e pa mirëmbajtura pengonin transportin e makinave. Transporti detar kryhej kryesisht nga kompani të huaja. Transporti ajror i postës operohej nga italianët. Tregtia ishte elementi më i madh i ekonomisë dhe gjatë kësaj kohe qarkullimi i mallrave u rrit. Lëndët e para dhe blegtoria ishin eksportet kryesore.

Shumë kompani italiane, angleze, franceze dhe amerikane filluan të bëjnë biznes në tregun shqiptar, të cilat u ndihmuan me marrëveshje tregtare ose me investime direkte.

Pozicioni i Italisë u forcua më tej nga Traktati i Tregtisë Detare, i cili i dha shtetit statusin e “kombit më të favorizuar”. Kjo legalizoi monopolin italian në tregtinë e jashtme.

Depërtimi italian

Në këmbim të ndihmës për pushtimin e Zogut, Beogradi priste shlyerjen në formën e territorit dhe ndikimit në Tiranë. Megjithëse Zogu i premtoi Beogradit lëshime kufitare përpara pushtimit, udhëheqësi shqiptar vazhdoi të ushtronte presion mbi pretendimet territoriale të Shqipërisë.

Më 30 korrik 1925, të dy kombet nënshkruan një marrëveshje për dorëzimin e Manastirit të Shën Naumit në Liqenin e Ohrit, dhe territoreve të tjera kufitare të diskutueshme në duart e Jugosllavëve. Megjithatë, Jugosllavia nuk mori kurrë atë që shpresonte kur investoi te Zogu. Ai iu shmang Beogradit dhe e ktheu Shqipërinë drejt

Italisë për mbrojtje.

Mbrojtësit italianë të zgjerimit territorial në Shqipëri u forcuan në tetor 1922, kur Benito Musolini mori pushtetin në Romë. Mbështetësit e tij fashistë ndërmorën një program që synonte krijimin e një perandorie të re romake në rajonin e Mesdheut që do të rivalizonte Britaninë dhe Francën. Musolini e pa Shqipërinë si një pikëmbështetje në Ballkan dhe pas luftës Fuqitë e Mëdha njohën një protektorat italian mbi Shqipërinë.

Në maj të vitit 1925, Italia filloi një depërtim në jetën kombëtare të Shqipërisë që do të arrinte kulmin katërmbëdhjetë vjet më vonë me pushtimin dhe aneksimin e Shqipërisë. Hapi i parë i madh në këtë proces ishte marrëveshja midis Romës dhe Tiranës që i mundësoi Italisë të shfrytëzonte burimet minerale të Shqipërisë. Së shpejti, parlamenti i Shqipërisë ra dakord të lejonte italianët të themelonin Bankën Kombëtare Shqiptare, e cila vepronte si thesari shqiptar edhe pse zyra kryesore e saj ishte në Romë dhe bankat italiane e kontrollonin atë. Shqiptarët gjithashtu u dhanë kompanive italiane të transportit një monopol në transportin e mallrave dhe pasagjerëve drejt dhe nga Shqipëria.

Në fund të vitit 1925, Shoqëria për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë, e mbështetur nga Italia, filloi t'i jepte hua qeverisë shqiptare fonde me interesa të larta për projektet e transportit, bujqësisë dhe punëve publike, përfshirë edhe pallatin e Zogut. Në fund, kreditë rezultuan të ishin subvencione.

Në mesin e vitit 1926, Italia nisi të zgjeronte ndikimin e saj politik në Shqipëri, duke i kërkuar Tiranës të njihte interesin e veçantë të Romës për Shqipërinë dhe të pranonte instruktorë italianë në ushtri dhe polici. Zogu rezistoi derisa një kryengritje në malet e veriut i bëri presion udhëheqësit shqiptar për të përfunduar Traktatin e Parë të Tiranës me italianët, më 27 nëntor 1926. Në traktat, të dy shtetet ranë dakord të mos lidhnin asnjë marrëveshje me asnjë shtet tjetër që dëmton interesat e tyre reciproke. Marrëveshja, garantonte pozicionin politik të Zogut në Shqipëri, si dhe integritetin territorial të vendit.

Në nëntor 1927, Shqipëria dhe Italia hynë në një aleancë mbrojtëse, Traktatin e Dytë të Tiranës, i cili solli një gjeneral italian dhe rreth dyzet oficerë për të trajnuar ushtrinë shqiptare.

Shumë shpejt ekspertët ushtarakë italianë filluan të udhëzojnë grupet paraushtarake të të rinjve. Tirana gjithashtu lejoi hyrjen e marinës italiane në portin e Vlorës dhe shqiptarët morën dërgesa të mëdha armatimi nga Italia.

“Trimëria nuk njih gjini”

Vajzat ushtarake në rrugëtimin e tyre historik

Rrugëtimi i vajzave shqiptare për t'u bërë pjesë e Ushtrisë Popullore, zanafillën e saj e ka që prej formacioneve partizane, ku lufta dhe përpjekja për largimin e pushtuesve të huaj ka qenë e barabartë me atë të partizanëve djem. Ato nuk iu stepën plumbit armik dhe me gjithë forcën e tyre donin të kontribuonin për mbrojtjen e tokës amë, për të cilën dhanë jetën me mijëra bij dhe bija.

Ato nuk zgjodhën...

Radhët e ushtrisë po shtoheshin nga vajzat e ardhura nga të katër skajet e vendit. Me formime të ndryshme, por të gjitha i bashkonte shpirti luftarak i pamposhtur, me rreshtat standarde ushtarake në atë qiell të madh e të lirë të asaj kohe dhe që i dallonte nga femrat e tjera, që nuk i përkisnin radhëve të tyre. Ato u mësuan me jetën ushtarake përkrah shokëve të tyre të asaj kohe, me të cilët një pjesë krijoi familje...

Ato krijuan një miqësi midis tyre dhe kolegëve të tyre, duke i shtuar karakterit virtytet më të bukura të dashurisë, sinqeritetit, modestisë, bashkëpunimit e besnikërisë ndaj atdheut, me të cilën u edukuan.

Ishin ato që qëndruan krenare e të papërkulura në poligonet e qitjes, në transhe, me alarme... Ishin ato që zhvilluan e realizuan me sukses çdo detyrë të caktuar në lojërat e vështira luftarake në mjaft vende e rrethe, mes trashësisë së dëborës, acareve të dimrit, shiut e breshrit që u binte mbi kapotë, duke rënduar shpatullat e tyre të njoma deri në palcë me pushkën krahut, gjerdanin e fishekëve në qafë dhe kundërgazin në kokë.

Të tilla ishin këto vajza! Një ndërthurje e jashtëzakonshme e vitalitetit e miqësisë ushtarake. Jo pak kanë qenë gratë ushtarake që kanë dhënë jetën e tyre në shërbim të vendit dhe jo vetëm.

Shumë njerëz nuk e dinë rolin që kanë luajtur gratë gjatë historisë. Me shërbimin ushtarak gratë vishen si burra dhe luftojnë krah për krah. Në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, shumë njerëz e dinin se gratë shërbenin si infermiere, por a e dini se roli i grave u zgjerua shumë jashtë rolit të infermiereve dhe shpërndarëseve të trakteve.

Nga detyra aktive te detyra e pelenave

“Të jesh grua, të jesh në gjendje të shërbesh në ushtri, tregon gratë në këtë vend dhe sa larg kanë arritur ato. Cilat janë mundësitë e mëdha për të qenë një ‘Teutë’ apo një ‘Shotë’ dhe gjithë shkëlqimin që u jep të qenit grua.

FARSH nderon sakrificat dhe arritjet e grave që jo vetëm formësuan shërbimin tonë, por edhe vendin. Gratë luajnë një rol jetik në ushtrinë e sotme, ato janë Ushtarët në vijën e parë; ato janë udhëheqëse, oficerë dhe nënofficere që qëndrojnë me trupat tona; ato janë punëdhënëse, bashkëshorte, nëna dhe motra. Nderim për të gjitha gratë, për shërbimin e tyre ushtarak dhe civil, mbështetjen dhe forcën e tyre dhe sakrificat e tyre për të ndihmuar në sigurimin e lirisë. Nuk duhet të presim muajin Marsi, i njohur tanimë si Muaji Kombëtar i Historisë së Grave dhe t'i bashkohemi kombit në një festë të përforcuar të kontributeve të grave për këtë komb. Vajzat në uniformën e gjelbër vazhdojnë të dëshmojnë çdo ditë aftësitë dhe gatishmërinë e tyre luftarake si pjesë e forcës totale dhe forcës civile të punës. Duke integruar plotësisht gratë në të gjitha aspektet e ushtrisë, duke përfshirë armët luftarake.

Gratë vazhdojnë të kenë një rol vendimtar në operacionet aktuale dhe sakrificat e tyre vetëmohuese, vazhdojnë të thejnë barrierat gjinore. “Trimëria nuk njih gjini”.

Ushtria e sotme është shumë më e integruar sipas linjave gjinore se në të kaluarën. Gratë nuk janë më të përjashtuara nga asnjë lloj misioni luftarak, ato janë pilote dhe drejtuese mjetesh, mekanike dhe oficerë këmbësorie. Në lidhshimin e lartë, shifrat janë më të këqija dhe pasqyrojnë punën që duhet bërë ende për të ndihmuar integrimin e grave në ushtri. Njëra prej tyre pati nderin të vendoste dy yje në supe dhe të bëhej grua e parë në historinë shqiptare, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Ne kemi nevojë për më shumë gra në gradat e larta të ushtrisë, nuk mjafton vetëm të bësh më mirë, me demografinë më të re dhe më të rinj, që do të thotë të gesh mënyra që gratë të kthehen dhe të vazhdojnë karrierën e tyre pasi të kenë fëmijë.

Kur bëhet fjalë për adresimin e çështjeve të nën-përfaqësimit, është e rëndësishme të shqyrtohet pengesa, barrierat që i pengojnë gratë të ndjekin shërbimin ushtarak, veçanërisht, se mbetet shumë e vështirë të kesh një familje gjatë shërbimit ushtarak, dhe kjo është e vërtetë edhe më shumë për gratë sesa për burrat.



Shtigjet e karrierës që ofrojnë mënyra më realiste për t'u rikthyer në shërbimin ushtarak pas një mungese të zgjatur duhet të vazhdojnë të zhvillohen nga shërbimet ushtarake.

Ngritja e zërit të grave

Për të rritur përfaqësimin dhe tërheqjen e shërbimit ushtarak për gratë, ne duhet të përforcojmë zërat e grave që kanë pasur nderin të shërbejnë për të përhapur fjalën se sa përmbushëse mund të jetë. Ato mund të jenë ndër më bindëset dhe gjithashtu më frymëzueset për vajzat dhe gratë në karrierën ushtarake.



Të jesh grua do të thotë të luftosh pa iu trembur sfidave dhe të ardhmes, ajo është e ndritur kur këmbëngulja dhe ambicia të çojnë në destinacion. Gratë shqiptare e kanë treguar këtë, në kohë lufte dhe paqeje ato ia kanë dalë të bëjnë rolet që i ka caktuar “nëna natyrë” dhe dëshira për të ecur Përpara.

1642 gra dhe vajza janë çdo ditë në shërbim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

687 civile sjellin profesionalizëm në administratë.

955 në uniformë mbrojnë atdheun me guxim dhe përkushtim.



“Rritja e bashkëpunimit NATO-BE është thelbësore”

Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e NATO-s Radmila Shekerinska iu drejtua konferencës vjetore të Agjencisë Evropiane të Mbrojtjes (EDA) “Horizontet e reja në mbrojtjen e BE”. Ajo vlerësoi thellimin e partneritetit midis NATO-s dhe Bashkimit Evropian (BE) gjatë viteve të fundit dhe bëri thirrje për bashkëpunim edhe më të ngushtë. “Në këtë kohë të rrezikshme për sigurinë tonë, rritja e bashkëpunimit tonë është thelbësore”, tha ajo, duke nënvizuar se mbrojtja e BE-së është e një rëndësie të madhe për NATO-n, sepse ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me sigurinë transatlantike.

“Përballë konkurrencës strategjike në rritje dhe fushatave destabilizuese kundër sigurisë dhe mënyrës sonë të jetesës, rritja e investimeve në mbrojtje dhe rritja e prodhimit të mbrojtjes janë një prioritet për të siguruar që vendet në Evropë të qëndrojnë të sigurta”, - tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm. Ajo përshëndeti përpjekjet e shtuara të BE-së për të nxitur industrinë evropiane të mbrojtjes, për të fituar aftësi shumë të nevojshme dhe për të rritur elasticitetin.

Zonja Shekeinska theksoi rëndësinë që NATO dhe BE të punojnë krah për krah për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve dhe për të identifikuar më shumë mundësi për të shfrytëzuar ekspertizën, mjetet dhe burimet unike të njëra-tjetrës. Ajo inkurajoi gjithashtu përfshirjen “më të plotë të mundshme” të industrive të mbrojtjes të aleatëve jo-BE, të cilat kontribuojnë në njohuritë thelbësore teknologjike dhe ofrojnë aftësi të nevojshme urgjentisht.

Marrëdhëniet me Bashkimin Evropian

Bashkimi Evropian (BE) është një partner thelbësor për NATO-n. Të dy organizatat ndajnë vlera të përbashkëta, interesa strategjike dhe një shumicë të vendeve anëtare. Ata punojnë krah për krah në menaxhimin e krizave, në zhvillimin e aftësive, në adresimin e kërcënimeve dhe sfidave hibride të paraqitura nga konkurrenca strategjike në rritje, si dhe në ndërtimin e kapaciteteve të partnerëve të tyre të përbashkët në lindje dhe jug. NATO dhe BE kanë 23 anëtarë të përbashkët: Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja dhe Suedia.

Partneriteti strategjik dhe dialogu politik

Forcimi i partneritetit NATO-BE është veçanërisht i rëndësishëm në mjedisin aktual të sigurisë, në të cilin të dyja organizatat dhe anëtarët e tyre po përballen me kërcënime dhe sfida të ngjashme në lindje dhe jug.

Gama e temave të diskutuara ndërmjet NATO-s dhe BE-së është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Dialogu politik mbulon spektrin e plotë të çështjeve të rëndësishme për të dyja organizatat, duke përfshirë sfidat strategjike të paraqitura nga Rusia dhe Kina, situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe Lindjen e Mesme, forcimin e qëndrueshmërisë, kërcënimet kibernetike dhe hibride dhe luftimin e dezinformimit. Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014, dhe veçanërisht që nga pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia në vitin 2022, të dyja organizatat kanë demonstruar qartë unitetin e tyre politik dhe komplementaritetin e përpjekjeve në solidaritet dhe përkushtim për të mbështetur Ukrainën.

Si funksionojnë NATO dhe BE së bashku?

NATO dhe BE takohen rregullisht për të diskutuar çështje me interes të përbashkët. Takimet zhvillohen në nivele të ndryshme duke përfshirë në nivel të Ministrave të Mbrojtjes dhe të Jashtëm, Ambasadorëve, përfaqësuesve ushtarakë dhe këshilltarëve të mbrojtjes. Ka bisedime të rregullta staf me staf në të gjitha nivelet midis Stafit Ndërkombëtar të NATO-s dhe Stafit Ushtarak Ndërkombëtar, dhe bashkëbiseduesve të tyre përkatës të BE-së (Shërbimi Evropian i Veprimt të Jashtëm, Komisioni Evropian, Agjencia Evropiane e Mbrojtjes dhe Parlamenti Evropian).

Marrëveshjet e përhershme të ndërlidhjes ushtarake janë krijuar për të lehtësuar bashkëpunimin në nivel operacional. Një Ekip i Përhershëm Ndërlidhës i NATO-s ka operuar në Shtabin Ushtarak të BE-së që nga nëntori 2005 dhe një Celula e BE-së u krijua në SHAPE (komandë strategjike e NATO-s për operacionet në Mons, Belgjikë) në mars 2006.

Fushat kryesore të bashkëpunimit

Zhvillimi i aftësive mbrojtëse: Njëzet e tre aleatë të NATO-s janë gjithashtu shtete anëtare të BE-së, secila prej të cilave ka burime të kufizuara dhe një grup të vetëm forcash. Sigurimi i ndërveprimit të aftësive mbrojtëse të NATO-s dhe BE-së është si rrjedhim një prioritet për të dyja organizatat. Po punohet për të siguruar konsistencën midis rezulttit të Planit të Zhvillimit të Aftësive të BE-së (CDP), Procesit Kryesor të Objektivit (HLGP) dhe Rishikimit të Koordinuar Vjetor mbi Mbrojtjen (CARD) dhe proceseve përkatëse të NATO-s – siç është Procesi i Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s (NDPP) dhe Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit (PARP) – veçanërisht përmes pjesëmarrjes së tërthortë në takime dhe kontakteve ndërmjet stafit.



Lëvizshmëria ushtarake: Bashkëpunimi NATO-BE për lëvizshmërinë ushtarake është gjithashtu thelbësor. Të dyja organizatat përpiqen të sigurojnë që qasjet e tyre përkatëse të jenë koherente dhe të kërkojnë sinergji kudo që të jetë e mundur. Një Dialog i Strukturuar mbi Lëvizshmërinë Ushtarake, duke bashkuar aktorët kryesorë të të dyja organizatave, ka rezultuar vendimtar në këtë drejtim. I krijuar në vitin 2018, ai lejon stafet të diskutojnë prioritetet e përbashkëta si kërkesat ushtarake, infrastruktura e transportit, transporti i mallrave të rrezikshme, doganat, si dhe lejet e lëvizjes ndërkufitare dhe ushtrimet përkatëse.

Kundër kërcënimeve hibride: NATO dhe BE vazhdojnë të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre për të luftuar kërcënimet hibride. Qendra Evropiane e Ekselencës për Kundër Kërcënimeve Hibride e vendosur në Helsinki, Finlandë funksionon si një forum për shkëmbimet ndërmjet NATO-s dhe BE-së, duke i afruar të dyja organizatat.

Siguria kibernetike dhe mbrojtja: Stafi i NATO-s dhe BE-së angazhohen rregullisht në zhvillimet që ndikojnë në sigurinë kibernetike dhe politikën e mbrojtjes për të siguruar ndërjegjësimin e përbashkët të situatës. Marrëveshja Teknike për Mbrojtjen Kibernetike ndërmjet Aftësisë për Reagim ndaj Incidenteve Kompjuterike të NATO-s (tani e njohur si Qendra e Sigurisë Kibernetike e NATO-s) dhe Ekipit të Reagimit ndaj Emergjencave Kompjuterike për institucionet, organet dhe agjencitë e BE-së (CERT-EU) ofron një kornizë për shkëmbimin e informacionit praktikat më të mira ndërmjet ekipeve të reagimit ndaj emergjencave.

Rezistenca, gatishmëria civile dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike: Mjedi aktual i sigurisë ka çuar në një fokus të ripërtërirë në gatishmërinë civile dhe qëndrueshmërinë. NATO dhe BE kanë rritur bashkëpunimin e tyre për të trajtuar dobësitë në infrastrukturën kritike, si dhe për të përmirësuar transportin dhe aspektet rregullatore të lëvizshmërisë ushtarake. Kjo ka nënkuptuar një fokus të shtuar në legjislacionin, rregulloret dhe procedurat e koordinuara të kalimit kufitar, duke përfshirë transportin e mallrave të rrezikshme.

Ushtrime për menaxhimin e krizës: NATO dhe BE kanë forcuar ndërveprimin e tyre në fushën e ushtrimeve të menaxhimit të krizave, të cilat ndihmojnë në rritjen e elasticitetit dhe gatishmërisë së të dyja organizatave. Për shembull, në 2022-2023, NATO dhe BE ndoqën Planin për Zbatimin e Ushtrimeve Paralele dhe të Koordinuara (PACE). Në mënyrë reciproke, stafi nga Komisioni Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Shërbimi Evropian i Veprimt të Jashtëm morën pjesë në planifikimin dhe zhvillimin e stërvitjes së NATO-s për menaxhimin e krizave në vitin 2023 (nën PACE23). PACE për 2024-2025 u miratua në shkurt 2024.

Terrorizmi dhe përhapja e WMD: Si NATO ashtu edhe BE-ja janë të përkushtuara për të luftuar terrorizmin dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë (WMD). Ata kanë shkëmbyer informacion mbi aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së popullatës civile kundër sulmeve kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Detin Egje dhe Mesdheun Qendror: Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s vendosën më 11 shkurt 2016 të nisin Aktivitetin Egje të Aleancës, duke vendosur anije në Detin Egje për të mbështetur Greqinë dhe Turqinë, si dhe

agjencinë kufitare të Bashkimit Evropian “Frontex”, në përpjekjet e tyre për të trajtuar krizën e refugjatëve dhe emigrantëve. Dislokimi në Detin Egje synon të mbështesë përpjekjet ndërkombëtare për të shkurtuar linjat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit të paligjshëm. Në tetor 2016, Ministrat e Mbrojtjes zgjeruan vendosjen e NATO-s në Detin Egje dhe vendosën që Operacioni i ri i NATO-s “Sea Guardian” do të mbështeste operacionin e BE-së “Sophia” në Mesdheun Qendror me anije dhe avionë të NATO-s për të ndihmuar në rritjen e ndërjegjësimit të situatës së BE-së dhe për të ofruar mbështetje logjistike.

Ballkani Perëndimor: Në korrik 2003, BE dhe NATO publikuan një “Qasje të Konkretuar për Ballkanin Perëndimor”. I hartuar së bashku, ai përshkruan fushat kryesore të bashkëpunimit dhe thekson vizionin dhe vendosmërinë e përbashkët që të dyja organizatat ndajnë për të sjellë stabilitet në rajon.

Maqedonia e Veriut: Më 31 mars 2003, Operacioni “Concordia” i udhëhequr nga BE-ja mori përsipër përgjegjësitë e misionit të drejtuar nga NATO, Operacioni Aleat “Harmony”, në vendin e njohur në atë kohë si ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Bosnjë-Hercegovinë: Duke u mbështetur në rezultatet e Operacionit “Concordia” dhe pas përfundimit të Forcës së Stabilizimit të udhëhequr nga NATO (SFOR) në Bosnje-Hercegovinë, BE-ja vendosi një mision të ri - Operacioni “Althea” - më 2 dhjetor 2004. Forca e BE-së (EUFOR) vepron nën Marrëveshjet “Berlin Plus”, duke u mbështetur në ekspertizën e planifikimit të NATO-s dhe në asete dhe aftësi të tjera të Aleancës.

Kosova: NATO ka udhëhequr një forcë paqeruajtëse në Kosovë (KFOR) që nga viti 1999. BE-ja ka kontribuar me asete civile në Misionin e OKB-së në Kosovë (UNMIK) për vite me radhë dhe ka rënë dakord të marrë përsipër komponentin policor të Misionit të OKB-së. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) në Kosovë, i cili u vendos në dhjetor 2008, është misioni më i madh civil i nisur ndonjëherë në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP). Synimi qendror është të ndihmojë dhe mbështesë autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, veçanërisht në fushën e policisë, gjyqësorit dhe doganave. EULEX-i punon ngushtë me KFOR-in në terren.

Bashkëpunimi në rajone të tjera

Iraku: Si NATO ashtu edhe BE-ja ruajnë praninë në Irak. BE-ja po fokusohet në sektorin e sigurisë civile. NATO po ndihmon në ndërtimin e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes dhe sigurisë irakiane dhe po i përshkallëzon këto përpjekje me një mision këshillues jo luftarak të nisur në Samitin e Brukselit në korrik 2018, me kërkesë të qeverisë së Irakut.

Afganistani: NATO dhe BE luajtën role kyçe si pjesë e përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare në Afganistan. Forca Ndërkombëtare e Ndihmës për Sigurinë e udhëhequr nga NATO (ISAF) ndihmoi në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të sigurt në të cilin qeveria afgane si dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë mund të ndërtonin institucione demokratike, të zgjeronin sundimin e ligjit dhe të rindërtonin vendin.

Darfur: Si NATO ashtu edhe BE-ja mbështetën misionin e Bashkimit Afrikan në Darfur, Sudan, veçanërisht në lidhje me rotacionet e transportit ajror.

Mijëra vjet më parë, njerëzimi ishte një specie nomade, që ecte në Tokë dhe strehohej në shpella, ndërsa gjuante dhe mblidhte manaferrat për të mbijetuar. Ne kemi bërë një rrugë të gjatë që atëherë, por ku do të shkojmë nga këtu?

Disa ekspertë kanë folur rreth asaj se sa shumë do të ndryshojnë njerëzit në 50,000 vjet dhe rezultatet janë magjepsëse.



E ardhmja e njerëzimit

Jason Hodgson, një antropolog dhe gjenetist evolucionar në Universitetin Anglia Ruskin në Mbretërinë e Bashkuar, ka shprehur disa ide se si 50 mijëvjeçarë mund të ndryshojnë këndvështrimin e njerëzimit.



Hodgson pohon se është e mundur që popullsia globale të bëhet më homogjene në të ardhmen, me dallimet në racën dhe llojin e trupit, duke u bërë të paqarta në një popullsi botërore gjithnjë e më të lidhur.

Brezi i bukur

Nick Longrich, një paleontolog dhe biolog evolucionar në Universitetin e Bath në Mbretërinë e Bashkuar, thotë se përzgjedhja natyrore mund të çojë që brezat e rinj të bëhen më të gjatë dhe më të bukur.



Evolucion



Ndërhyrja në ADN

Kjo nuk po merr parasysh as mjetet e mundshme që mund të përdorim në të ardhmen për të modifikuar dhe madje ndryshuar gjenet tona, duke hapur një botë të tërë opsionesh për trupin dhe mendjen tonë.


Në disa mijëvjeçarë nga tani, njerëzimi ndoshta do të ketë shfrytëzuar tashmë përdorimin e energjisë së pastër dhe kolonizimin e hapësirës.

Problemet e sotme, makthi i së nesërme?

Në të njëjtën kohë, probleme të tilla si varfërimi i burimeve, mbipopullimi dhe ndryshimet klimatike vënë në pikëpyetje se sa gjatë do të vazhdojë të ekzistojë në Tokë njerëzimi.

Çfarë është një mijëvjeçar, gjithsesi?

Megjithatë, jo të gjithë besojnë se 50,000 vjet janë kaq shumë kur bëhet fjalë për evolucionin njerëzor. Për shembull, është mendimi



i Thomas Mailund, një profesor i asociuar i bioinformatikës në Universitetin Aarhus në Danimarkë.

“Ne nuk do të rritim krahë apo gushë në më pak se miliona vjet, dhe 50,000 vjet më parë, ne ishim njerëz anatomikisht modernë”, shpjegon Mailund.

Dronët e parë në botë, të lëshuar nga nëndetëse, që notojnë dhe fluturojnë, përmbëjnë një kërcënim të ri për SHBA-në

Kina thuhet se ka zhvilluar një dron që mund të kryejë operacione nënujore dhe ajrore. Dronët e lëshuar nga nëndetëse gjithashtu kanë një shkallë më të lartë të mbijetesës në fushat e betejës detare, sipas pretendimeve.

Droni më i fundit kinez është zhvilluar pasi Pekini ka frikë se Shtetet e Bashkuara mund të vendosin së shpejti dronë nënujorë pranë ujërave të gjigantit aziatik për të nisur sulme të befasishme mbi PLA gjatë një konflikti të mundshëm në Tajvan në të ardhmen.

Megjithatë, Kina pretendon se dronët e saj të fundit janë më të avancuar se ata që përdoren nga divizioni UUV (automjet nënujor pa pilot) i Pentagonit.

Dizajn unik i krahëve të palosshëm

Zhvilluar nga studiues nga Universiteti Politeknik Veriperëndimor (NWPU) dhe Qendra e Kërkimit dhe Zhvillimit të Aerodinamikës së Kinës (CARDK), droni është i pari i këtij lloji në botë dhe ka një dizajn unik të krahëve të palosshëm. Kjo e ndihmon atë të lëvizë nëpër media ujë-ajër shumë herë në një udhëtim të vetëm.

Studiuesit kinezë pohojnë se dizajni i dronit përmirëson fshehjen dhe mbijetesën e tij në medime të ndryshme.

Botuar në “Acta Aeronautica et Astronautica Sinica”, një revistë e drejtuar nga Shoqëria Kineze e Aeronautikës, teknologjia më e fundit kombinon avantazhet e navigimit efikas nënujor dhe shkathtësisë së lartë në ajër.



për t’u zhytur ndërsa krahët e dronit palosen.

Ekipi i projektit, i udhëhequr nga profesori i asociuar i NWPU, Dong Changyin, pohon se droni, me mbështetjen e teknologjisë së inteligjencës artificiale, mund të kryejë në mënyrë autonome “misione të caktuara me kërkesa specifike”.

Në të kundërt, dronët e planifikuar për t’u përdorur nga ushtria amerikane duhet të transportohen në sipërfaqe në një tub të ngjashëm me silurët dhe të mos kenë lëvizshmëri nën ujë. Më pas, pas daljes nga deti, ata duhet të qëndrojnë në ajër, kështu që ata janë më të ndjeshëm ndaj sulmit, sipas SCMP.

NWPU dhe CARDK e Kinës po udhëheqin zhvillimin e teknologjive të avancuara, duke përfshirë armët më të fundit, si automjetet hipersonike, në vendin aziatik.

Raportet kanë zbuluar se Pekini gjithashtu planifikon të zhvillojë lloje të shumta armësh ndër-media, disa prej të cilave mund të përdorin motorë ramjet me karburant të ngurtë për lundrim me shpejtësi të lartë në mjete ajrore dhe nënujore.

Një raport i publikuar nga Qendra për Sigurinë e Re Amerikane (CNAS) parashikoi gjithashtu se një konflikt i mundshëm i ardhshëm midis Tajvanit dhe Kinës do të formësohej nga metodat e reja të luftës me dron që përfshijnë dronët e avancuar nënujor dhe nivelet e rritura të autonomisë.

Droni mund të kryejë operacione zbulimi dhe sulmi


I quajtur “Feiyi” nga studiuesit kinezë, droni pretendohet se ka potencial të madh aplikimi në fushat ushtarake dhe mund të kryejë operacione zbulimi, vëzhgimi, sulmi dhe sulmi detar.

Aftësitë e navigimit nënujor të “Feiyi” janë veçanërisht mbresëlënëse, me efikasitetin e tij të udhëtimit që tejkalon atë të shumicës së dronëve ekzistues ndër-media. Kjo është kryesisht sepse katër palët e tij të teheve rrotulluese për fluturim mund të rrotullohen dhe palosen si krahët e njeriut, duke lejuar që sipërfaqet e parregullta të tehut të ngjiten fort në trup, duke reduktuar kështu rezistencën ndaj ujit, raportoi SCMP.

Droni ka helikë të montuar në bisht, të cilat i sigurojnë atij shtytje dhe drejtim të fuqishëm për operacionet nënujore.

Dronit të ri të Kinës i duhen pesë sekonda për t’u zhytur

Droni i mesëm ndër-mesatar pretendohet se ka aftësinë për të mbajtur një qëndrim të drejtë në valë të përafërta ndërsa arrin në sipërfaqe. Droni më pas mund të përhapë katër krahët e tij për t’u ngjitur në ajër. Gjatë uljes në ujë, dronit i duhen pesë sekonda



MALL “SKËNDERBEGASISH”



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

(Në pritje të 80-vjetorit të Shkollës “Skënderbej”)

Skënderbegasit dhe Shkolla “Skënderbej” në krijimet letrare dhe artistike

Nuk besoj të ketë një shkollë tjetër në Shqipëri që t’i jenë thurur aq shumë këngë e poezi, t’i jenë bërë skica e grafika, portrete e tablo, sa Shkollës “Skënderbej”. Dhe nuk di nëse ka ndonjë shpjegim e aq më pak ndonjë studim për këtë. Kur isha maturant kam bërë një shkrim për poemën e famshme të Hysni Milloshtit “Vatra e Kuqe”, botuar në revistën “10 Korriku”, që fatkeqësisht më ka humbur. Padyshim ajo poemë është dhe mbetet krijimi më i arrirë, më i plotë dhe më i bukur për Shkollën tonë. Milloshi, si askush tjetër, ka nxjerrë në pah jo thjesht figurën e skënderbegasit, figurën e një adoleshenti me uniformë ushtarake, por ai ka krijuar një hero sa lirik aq dhe epik, sa të ndjeshëm aq dhe trim e guximtar, një djalosh me ëndrra, dëshira, ideale... Por poeti nuk e ndan heroin e tij nga mjedisi ku ai jeton, rritet, mëson, kalitet për vështirësitë që e presin, edukohet me dashurinë për Atdehun, përgatitet për mbrojtjen e tij. Pavarësisht se kur shkruan ato vargje ai e sheh Shkollën nga perspektiva e disa viteve pasi e ka mbaruar, dhe është e kuptueshme një notë malli e nostalgjie: ... Tek kjo portë ja erdha përsëri/ Të ndjek rininë time të bukur... ai ka mbetur ai djaloshi ëndërrimtar e guximtar/...që te ky prag nisi jetë tjetër/, ai djaloshi që i jep udhë fantazisë ...nga rreshti gjer te Skënderbeu/ e që e sheh... si zbret nga malet e përhime/mbi copa eshtrash që nuk i tret dheu... Kjo lidhje e skënderbegasve me Heroin tonë Kombëtar është ndoshta një nga tiparet më të qenësishme dhe më të rëndësishme në formimin e atyre më se 30 mijë nxënësve që kaluan në bankat e asaj Shkolle në 57 vite jetë të saj. Ne na dukeshin jo vetëm të bukur, por edhe të natyrshëm, se nuk mund të ishin ndryshe ato vargjet e këngës, që aq bukur e këndonte Kujtim Turku e më pas edhe Bahri Rustja: Skënderbegas mua më thonë/ Emrin kam luftëtar... pasi në ndërgjegje, por edhe në nëndërgjegje, në biseda apo në ëndrra, e shihnim veten si kalorës të Skënderbeut, trima dhe të fortë e të pamposhtur si ai. “Ne, - thotë në një poezi Sali Frangu, - erdhëm të ngremë kala me mure të rënda...”. E Xheladin Çelmeta i përfytyron shokët e tij në marshim si një shigjetë të ndritshme drejt diellit. Figura të tilla, si kështjella, çelik, shpata, legjenda, edhe kur nuk përmendet Skënderbeu, natyrshëm rrjedhin nga imazhi i tij. Emri i tij, lavdia e tij, krenaria që u formuam në një Shkollë me emrin e tij, në ndoqi tërë jetën.

Në vitin 2017, pas vitesh e për disa edhe pas dekadash pasi ishim larguar jo vetëm nga jeta ushtarake, por edhe nga Atdehu e kishim emigruar, ne një grup ushtarakësh shqiptarë me banim në



Nju Jork, krijuam një Shoqatë, e, pa u menduar një sekondë, kur erdhi momenti si ta quanim, thamë emrin e emërmadhit Skënderbej. Pse? Kjo ide na erdhi natyrshëm, ishte si të thoshe se nuk kish një emër tjetër që t’i shkonte përshtat Shoqatës sonë. Aty nuk ishin të gjithë ish-skënderbegas, por të gjithë e ndjenim se Skënderbeu ishte një mal i lartë, i fortë, ku ne mund të mbështeteshim pa frikë. Skënderbeu rrezaton ato vlera që edhe 8 mijë kilometra larg shqiptari të ndihet shqiptar. Por kjo e vërtetë është edhe më e vërtetë për ne, skënderbegasit.

Krijuesit skënderbegas e kanë provuar këtë me veprat e tyre. Por do të ishte e padrejtë dhe aspak e vërtetë nëse do t’i mëshonim vetëm pamjes epike apo heroike të krijimeve të skënderbegasve dhe për Shkollën SKËNDERBEJ. Do të doja që këto radhë t’i shkruaja në Shqipëri, që të kisha mundësi të hapja libra, gazeta e revista, të citoja vargje poetikë, fragmente tregimesh dhe... Sepse ata janë të shumtë e njëri më i bukur se tjetri. E s’ka si ndodh ndryshe, pasi janë thurur nga pena të rënda, nga autorë që kanë bërë emër në letrat shqipe. Kë të përmend më parë? Sabri Godon apo Lirim Dedën, Milianov Kallupin apo Luan Malajn, Thanas Tanen apo Roland Mustën, Agim Cergën apo Pavlo Gjideden, Maku Ponen apo Halil Lazen, Bashkim Kozelin, Demokrat Anastasin, Thanas Janin, Spiro Xhavarën, Fadil Zeqirin, Beqir Skrelin... Oh, janë shumë, shumë. Dhe secili ka sjellë diçka të vetën, secili ka ndjerë e përshkruar me penën e tij, d.m.th. me shpirtin e tij skena nga jeta në Shkollë. Njëri shkruan për blerimin e uniformës, një tjetër për mimozat që në mars i jepnin Shkollës një bukuri pranverore përrallore, një i tretë një motiv nga vajtja me leje the prindërit i gëzohen shtatit që ka hedhur dhe 10-ave në mësim, aty ca vargje për mësuesen e në një poezi tjetër

peizazhi i bukur nga një majë mali gjatë marshimit, dikush borës mbi supe e dikush armës, dikush miqësisë ushtarake e dikush mallit për një lëshverdhë a belhollë atje në vendlindje a të saponjohur rrugëve të Atdehut... Janë aq shumë motive. Motive që frymëzojnë jo vetëm vargje dhe këngë, por edhe piktura. Mbase skënderbegasi piktor më i famshëm është Piktori i Merituar Fatmir Haxhiu, Mjeshtër i Madh. Në tablonë e tij madhështore “Çajmë Rrethime”, disa nga portretet e partizanëve i mori mes skënderbegasve dhe studentëve ushtarakë. Por në faqet e “10 Korrikut” apo “Luftëtarit” etj., do të gjesht një galeri të tërë portretesh apo skicash nga jeta skënderbegase. E natyrisht Haxhiu nuk është i vetmi piktor. Robert Përmeti është një tjetër emër i njohur i arteve figurative shqiptare. Apo Fejzo Lalaj dhe Bashkim Alushi, Sefedin Stafa e sa të tjerë! E nuk mund të mos përmendim Arben Dukën. Nuk ka aspekt të jetës së Shkollës që Arbeni jo thjesht t’i ketë thurur vargje, por të mos i ketë kënduar me atë ritmin dhe rimën që vetëm pena e tij dinte si t’i thurte! Sepse Arbeni ishte këngëtar në shpirt dhe vargjet i dilnin melodiozë...O prag i kuq, o prag me yje/ Sa krenari për ty un’ ndjej/ Të ndrit në ballë si yll lavdie/ Emri i bukur SKËNDERBEJ... Emri i bukur SKËNDERBEJ!

Janë pra, këtu, tek bukuria e emrit, te gjithçka që bukuria përmbledh, atë fizike po e po, por sidomos bukuria e shpirtit, bukuria e bërë një me madhësinë, zgjuarsinë, shpirtin heroik, atë të sakrificës e plot tipare të tilla pa të cilat ne nuk mund ta përfytyronim e as mund ta përfytyrojmë edhe sot Heroin tonë Kombëtar, mbase duhet kërkuar ajo lidhje e skënderbegasve me Shkollën e tyre dhe me vetë emrin skënderbegas. Lidhje të cilën krijimet letrare e artistike kanë magjinë dhe misionin t’i ruajnë e tregojnë edhe pasi të pushojë së rrahuri zemra e skënderbegasit të fundit...



Fejzo Lalaj:
Portret Skënderbegasi



Piktori Bashkim Alushi
Portret i poetit skënderbegas Fluturak Gërmenji

URA E TAMARËS DHE HANI I SAJ,

simbole të trashëgimisë sonë kulturore

Ura e Tamarës dhe hani pranë saj, janë objekte të trashëgimisë sonë kulturore të cilat dëshmojnë për bukuritë dhe traditat shqiptare.

Ura e Tamarës e ndërtuar mbi lumin Cem të Vuklit, një kryevepër e shekullit XVIII, është ndërtuar nga vezirët Bushatllinj dhe mbetet një simbol i trashëgimisë sonë kulturore.

Gurët e saj tregojnë histori shekujsh, duke lidhur komunitete e kultura.

Pranë saj ndodhet Hani i Tamarës, dikur një strehë për udhëtarët dhe tregtarët, sot një kujtesë e mikpritjes dhe historisë shqiptare.

Këto vepra janë shpallur, në vitin 1984, Monumente Kulture të Kategorisë I dhe tregojnë pasurinë tonë historike dhe arkitekturore.

Ura e Tamarës në Kelmend, lidh Shkodrën me viset e malësisë. Pamjet e luginës, ku gjendet ura dhe hani, luginë e cila ka origjinë akullnajore është në lartësinë 1100 metra mbi nivelin e detit.

Në të dy anët e luginës ngrihen shpate malesh me pjerrësi të konsiderueshme dhe të veshura me pyje dhe kullota.

Bimësia drunore përbëhet kryesisht nga ahu dhe halorët.

Kjo zonë shquhet për panoramën si dhe për reshjet e shumta të dëborës.

Ndërtimi apo rindërtimi modern i Urës i kushtohet një gruaje me emrin Tamara, që thuhet se ishte bashkëshortja e Pashait të Shkodrës (mendohet e Karamahmut Pash Bushatliut). Në ato kohë thuhet se ura mbi lumin Cem (te Vuklit) ishte shumë e dobët, gjë e cila sillte shkatërrimin e herëpashershëm të kësaj ure nga reshjet dhe ujërat e rrëmbyeshëm të lumit.

Një rast i tillë i shkatërrimit të urës kishte ndodhur kur gruaja e Bushatliut të sipërcituar po kthehej nga gjinia e saj, thuhet nga Mali i Zi (por mendohet se gruaja me emrin Tamara ishte nga trojet etnike shqiptare të Gucisë...). Deri sa u “rindërtua” me mjete rrethimore ura mbi Cemin e Vuklit, gruas të Bushatliut iu desh të priste disa ditë... Kjo vonesë kishte mërzhitur Tamarën dhe bashkëshortin e saj.

Tamara me t’u kthyer në Shkodër ndërhyri tek i shoqi (Pashai i Shkodrës), i cili siguroi fondet për ndërtimin e Urës... Kur përfundoi së ndërtuari ura, për nder të gruas që beri të mundur këtë ndërtim, iu dha emri “URA E TAMARES”.

Në gojëdhënë thuhet se këtë emër e mori edhe Vendi, që nder shekuj kishte shërbyer me Hanet e tij si “qendër” pushimi për rrugëtarët që donin të kalonin nga Shkodra e më gjerë për në trojet e tjera të Shqipërisë Etnike, si në Guci, Plavë e më tej...

(Për gojëdhënë e mësipërme ka shkruar edhe gjeografi i njohur Kol Progni në librin e tij “KELMENDI”. Emri Tamara u trashëguar edhe në fillimet e shekullit XX, kur Tamara u bë fshat, dhe në vitin 1935 me një vendim të Qeverisë së Mbretërisë Shqiptare, iu dha emërtimi administrativ: Qendër e komunës Kelmend.

Ura e Tamarës është e bukur dhe mjaft komode. Ajo ka dy qemerë. Qemeri i madh është me 13 metra hapësirë drite, ndërsa qemeri i vogël ndodhet në krahun e djathtë. Mbi Urë janë hedhur shtresa betoni, që kanë lehtësuar kalimin e mjeteve të ndryshme.

Duke mos u mjaftuar vetëm me gojëdhëna për historinë e Urës së Tamarës, studiuesi nga Bosnja, LOVRO MIHAÇEVIQ, i cili për shumë vite ka qenë edhe famullitar në trojet e Malësisë së Madhe e më gjerë ka sjellë studimet e tij.

Disa nga studimet e tij me karakter historik dhe etnografik janë të botuara në librin me titull: “Nëpër Shqipëri”, 1883-1907, ku ndër të tjera shkruan: “...Ura e Tamarës ...është prej guri e mjaft e ngushtë, e gjatë është pesëdhjetë hapa. Me konstruksionin e vet tregon se vjen nga shekulli XV ose XVI nga koha kur venedikasit kalonin me karvanët tregtarë nëpër këtë rrugë, nga Shkodra e Tivari për në Guci, Plavë, Pejë e Shkup. Rruga për në Urë të Tamarës e deri në famullinë e Vuklit është shkëmb e shkrepa të gjallë...”

Studiuesi Mihaceviq nuk shkruan gjë për prejardhjen e emrit të urës...

Për emrin “Tamara” studiuesi dhe albanologu bullgar, Vladimir I. Georgiev, shkruan se është emër vendi me origjinë ILIRE, ndonëse në kumtesën e tij lexohet Tomara e jo Tamara... “Ilirët dhe Fqinjët e tyre”, Kuvendi i Studimeve Ilire, 15-20 shtator 1972, botim i Institutit të historisë të Akademisë së shkencave të RPSH.



Natyrisht kjo Urë ndër mote ka pësuar ndryshime të kohëve, duke iu përshtatur nevojave të udhëtimit, jo si dikur me mushq, kuaj, qerre, karroca e të tjera, por me automjete moderne siç i shohim edhe sot.

Me emrin e kësaj Ure janë të lidhura shumë ngjarje e data të historisë së Kelmendasve, po kujtojmë vetëm DY: Betejën antiotomane të vitit 1911 (që në histori njihet si beteja te Ura e Tamarës), dhe luftën mbrojtëse apo rezistencën antikomuniste të

Kelmendit, që e ka fillesën pranë kësaj ure, në fillim të vitit 1945, që shpesh në histori shkruhet “Lufta e Tamarës” etj...

Gjithsesi Ura e Tamarës, si të gjitha veprat ndërtimore shumëshekullore u është nënshtruar rikonstruksioneve të nevojshme ndër mote, duke i ndryshuar disi pamjen për mirë Urës, por këto rikonstruksione nuk i kanë ndryshuar trashëgiminë e vlerave të zhvillimit e qytetërimit, që rrezaton në historinë shumëshekullore të Kelmendit e më gjerë Ura e Tamarës.





FORCAT ARMATE FORCAT KOMANDO KRENARI PËR SHQIPËRINË BARAZI NË UNIFORMË